

# Rruga Arbërit

GAZETË E PAVARUR. NR. (7)27. KORRIK 2008. ÇMIMI: 50 LEKË. 20 DENARË. 1.5 EURO



"Risku" sh.p.k.  
Market "Ken"

Laprakë, Tiranë  
Tel: +355 4 22 50 480  
Cel. 068 20 36 394

## REPLIKË

### Si dac shëndreu

NGA: AGRON TUFA - FAQE 5

## REPORTAZH

### Trokitje në mëhallën e dibranëve

NGA: SHAOIR SKARRA - FAQE 7

## EMIGRACION

### Nuk kam gjunjë për Korab, Sali Hafuzi!

NGA: ABDURAHIM ASHIKU - FAQE 10

## TRADITE

### Dibra, kryeqendër e folklorit shqiptar

NGA: PËRPARIM TOMÇINI - FAQE 15

## SHENIM

### Shpronësim pa shpronësim

Megjithëse punimet në Rrugën e Arbërit kanë filluar, banorët nuk u bënë asnjëherë pengesë për vazhdimin e tyre, ashtu sic jemi mësuar të dëgjojmë në mjaft raste, ku po kryhen investime publike në vend. Shpronësimet u publikuan disa muaj më vonë, pikërisht në qershor të këtij viti, duke informuar edhe publikun dhe të shpronësuarit për vlerën e shpronësimeve.

Këto shpronësime zënë një sipërfaqe totale prej 37 770 m<sup>2</sup> arë dhe 204 m<sup>2</sup> truall. E gjithë vlera e shpronësimeve arrin 6.816.014 lekë ose mesatarisht 50.000 lekë për familje.

Vlera e truallit është llogaritur me 437 lekë/m<sup>2</sup>, ndërsa vlera e tokës arë, përkatësisht sipas fshatrave, më e ulëta është në Sofraçan me 84 lekë/m<sup>2</sup>, duke u rritur diçka në fshatin Dragu me 116 lekë/m<sup>2</sup>, në Fushë Bulqizë 122 lekë/m<sup>2</sup>, në Vajkal dhe Godvi me 197 lekë/m<sup>2</sup>, në Valikardhë me 218 lekë/m<sup>2</sup> dhe më e larta në Krajkë 246 lekë/m<sup>2</sup>.

E përkthyer ndryshe, një metër katror tokë arë në Sofraçan kushton përafërsisht sa 1 kg makarona dhe në Krajkë sa 1 litër vaj.

Parë në këtë këndvështrim, besoj se asnjëri prej banorëve nuk mbetet i kënaqur nga shpronësimet, por duke besuar se pjesa tjetër e tokës, ngjitur me rrugën, fiton më shumë vlerë, mendoj se nuk u ka shkuar ndërmend ndonjëherë të protestojnë. "Aq sa të marrim, le të marrim", kanë menduar.

(Vijon në faqen 6)

# "Rruga e Arbërit do të jetë një rrugë moderne"

Intervistë me Dr. Ing. **FARUK KABA**, drejtues i firmës "AF-InfraTransProjekt"



Aktualisht, një kompani italiane ka në dorë skemën e financimit të Rrugës së Arbërit, me një kredi me afat 11.5 vjet. Këtë kredi e merr kompania e huaj, e cila është e besueshme në bankat e fuqishme, ndërsa qeveria shqiptare garanton këtë kredi. Kompania e huaj ndërton rrugën shumë shpejt dhe menjëherë pas ndërtimit fillon shlyerja e borxhit. Imagjinoni sikur shteti, pa këtë kredi, të merrte përsipër ndërtimin për 11.5 vjet? Do të dukej sikur rruga nuk do të mbaronte kurrë. Në këtë mënyrë ne fitojmë rrugën, ndërsa firma fiton interesin e ndërtimit.

Faqe 2-3

## AKTUALITET

### Liberalizohen vizat me Maqedoninë

Nga: REXHEP TORTE - Faqe 6

## MJEDIS

### Reforma në pyje dhe kullota duhet të vazhdojë

Nga: REXHEP NDREU - Faqe 12

## ARSIM

### Shkolla pedagogjike, një fidanishte mësuesish

Nga: Dr. HASAN LEKA - Faqe 11

## KULTURË

### Doruntina Disha, dibrania që befasoi norvegjezët!

Nga: IBRAHIM EGRIU - Faqe 16



INTERVISTË ME RAMIZ GJININ / BOTOHET VËLLIMI ME TREGIME "RRËFIME NË HIJE"

## Bibolli, kjo vendinë imagjinare ku vegjeton një botë rrëfimore

Ramiz Gjini rikthehet për pushime në Shqipëri, por krahas vizitës në vendlindje dhe takimeve me miqtë që si harron dot, gjen kohë edhe të botojë tregimet e fundit, subjektet e të cilave janë sa nga jeta shqiptare po aq edhe amerikane.

Faqe 9

Rruga e Arbërit do do të plotësohet me të gjithë elementet e një rruge supermoderne: të gjithë kanalet do të jenë të veshur me beton ose kuneta, do ketë skarpate të veshura me rrjetë, mure mbajtës e pritës, sinjalistikë rrugore e kompletuar, vepra arti moderne...

intervistë



Redaksia e gazetës falënderon lexuesit dhe bashkëpunëtorët e saj për mesazhet dhe shkrimet e sjella për botim.

Redaksia u kujton bashkëpunëtorëve të saj, zotërinjve Selman Mziu, Qeram Cibaku, Përparim Tomçini, Bernard Zotaj, Xhelal Roçi, Kujtim Boriçi, Ymer Keta, Beqir Sina, Sakip Cami, Zabit Lleshi, etj., se shkrimet e tyre, për arsye vendi nuk janë botuar në këtë numër. Ato do të botohen në numrat e ardhshëm të gazetës "Rruga e Arbërit".

**Gjithashtu, ju kujtojmë bashkëpunëtorëve se shkrimet deri në dy faqe daktilografike kanë përparësi botimi.**

Ju falënderojmë që jeni pjesë e gazetës!



**DREJTOR:**  
Rakip Suli

**Këshilli Botues:**  
Musa Riçku  
Shaqir Skarra  
Bujar Karoshi

**Redaksia:**  
Në Dibër:  
Rexhep Torle  
Në Athinë:  
Abdurrahim Ashiku  
Në Itali:  
Selman Mziu  
Në New York:  
Beqir Sina  
Në Tiranë:  
Prof. Dr. Bashkim Lleshi,  
Naim Plaku

**Adresa e gazetës:**  
Rr. "Zenel Baboçi",  
Pall. "Ferar", Tiranë  
Tel. (04) 2233 283  
E-mail: rrugaearberit@gmail.com

**Opinionet dhe komentet e botuara nuk shprehin domosdoshmërisht qëndrimin e redaksisë**

# "Rruga e Arbërit do

**Intervistë me  
Dr. Ing. Faruk Kaba,  
drejtues i firmës  
"AF-InfraTransProjekt"**

**Pyetje: Zoti Kaba, firma juaj ka kryer Studimin e Fisibilitetit për gjithë segmentin e Rrugës së Arbërit dhe projektin teknik në segmentin Bulqizë - Ura e Çerenecit, ku aktualisht po kryhen punimet. A i keni ndjekur ato në terren dhe çmund të na thoni më në detaje?**

**Dr. Ing. Faruk Kaba:** Sigurisht që i kam ndjekur punimet për segmentin ku ato kanë filluar, nga dalja e Bulqizës deri te Ura e Çerenecit, për faktin se në një nga tre lotët ku po punohet, firma jonë kryen edhe detyrën e supervizionit.

Në këtë segment kanë dalë pika me vlerë arkologjike, gjë që mund të konsiderohet si forcë madhore dhe si rezultat ka pasur vonesa të punimeve. Kjo mund të ishte konstatuar dhe eliminuar që në fazën e fisibilitetit, por jo të gjitha detajet e një rruge 72 km mund të precizohen që në atë fazë. Në sensin tjetër, ne jemi përpjekur të bëjmë më të mirën e mundshme.

Duke kaluar në atë segment, kam parë edhe punimet që zhvillohen në dy lotet e tjera dhe shpresoj që të mos ketë ndryshime, që do t'a keqësonin situatën. Rregullat e shtetit përcaktojnë, që është ai që përcakton ecurinë e kësaj pune. Është e rëndësishme që ka patur në mënyrë permanente një vullnet të mirë për të përmisuar më tej rrugën në ndërtim. Me një vendim të Këshillit Teknik të Rrugëve për segmentin Bulqizë - Ura Cerencit, rruga nga gjerësi e asfaltit 7 metra, e menduar në fazën e fisibilitetit, u vendos të bëhej 9 metra, pa përfshirë bankinat. Kjo do t'i japë një ngjyrë mjaft pozitive rrugës. Bie fjala, ajo do të jetë më e gjerë se sa rruga Fushë Krujë - Shkodër. Nuk ka asnjë dyshim, që rruga po ecën mirë, punimet po kryhen sipas afatit, dhe shpresojmë që në fund të këtij viti, ky segment, që ndoshta është më i lehti, të ketë përfunduar. Aktualisht, qeveria shqiptare është shumë e angazhuar me financimin e Korridorit të Kosovës dhe besojmë se sapo të lirohet nga ajo barrë, sigurisht që punimet në Rrugën e Arbërit do të ecin shumë më shpejt.

Deri tani, besoj se jemi korrekt me të gjitha punimet.

**Pyetje: Me sa dimë, firma juaj po punon aktualisht mbi projek-zbatimin e segmentit Bulqizë-Ura e Vashës. Në ç'fazë është studimi dhe a mund të na bëni një panoramë të shkurtër të projektit?**

**F. Kaba:** Në momentet që po flasim, firma që unë drejtoj, është në përfundimin e projektit të zbatimit të segmentit nga dalja e Bulqizës deri te Ura e Vashës, ku është edhe pjesa e lidhjes me Klosin. Studimi është drejt përfundimit. Ky ka qenë një segment i vështirë, por sigurisht segmen-



**Me vendim të Këshillit Teknik të Rrugëve për segmentin Bulqizë - Ura Cerencit, rruga nga gjerësi e asfaltit 7 metra, e menduar në fazën e fisibilitetit, u vendos të bëhej 9 metra, pa përfshirë bankinat. Kjo do t'i japë një ngjyrë mjaft pozitive rrugës. Bie fjala, ajo do të jetë më e gjerë se sa rruga Fushë Krujë - Shkodër. Nuk ka asnjë dyshim, që rruga po ecën mirë, punimet po kryhen sipas afatit, dhe shpresojmë që në fund të këtij viti, ky segment, që ndoshta është më i lehti, të ketë përfunduar.**

tet më të vështirë janë dy lotet e tjerë, nga Ura e Vashës në Tiranë, që janë në fazën e tenderimit.

Në segmentin Ura Vashës-Bulqizë është edhe tuneli në Qafën e Buallit, i njohur që në fazën e fizibilitetit. Kemi bërë më të mirën e mundshme për atë dhe besoj se brenda muajit shtator, sipas kontratës që kemi me Drejtorinë e Përgjithshme të Rrugëve, do ta mbyllim edhe këtë segment.

Dicka shumë e rëndësishme: në alinimentin e përcaktuar në studimin e fizibilitetit janë mbi 6-7 kthesa me rreze minimale ose afër minimale, të cilat i kemi eliminuar të gjitha. D.m.th., në aspektin planimetrik, por diçka edhe në aspektin altimetrik, rruga është përmirësuar në krahasim me atë që kemi paraqitur në studimin e fizibilitetit.

Ajo që dua të theksoj dhe që është shumë e rëndësishme është se ky segment do të plotësohet me të gjithë elementet e një rruge supermoderne: të gjithë kanalet do të jenë të veshur, do të jenë veshur me beton ose kuneta, do ketë skarpate të veshura me rrjetë në ato vende ku janë gërmime të mëdha, mure mbajtës e pritës, sinjalistikë rrugore mëse e kompletuar, vepra arti moderne, skarpate të veshura me bar, etj. Do të jetë një segment tejet i kompletuar, pasi nuk kemi pa-

sur kufizime për vlerën e saj. Kemi bërë më të mirën, që rruga të jetë me të vërtetë ajo që e duan shqiptarët dhe veçanërisht dibranët.

**Pyetje: Prof. Dr. Bashkim Lleshi, në një shkrim për "Rruga e Arbërit" ka ngritur një shqetësim të tij për devijimin e rrugës në disa segmente, gjë që sipas tij, do dëmtojë cilësinë. Ç'mund të na thoni lidhur me këtë?**

**F. Kaba:** Prof. Bashkimi ka ngritur një shqetësim, që për mendimin tim nuk është i justifikueshëm, sepse rruga jo vetëm që nuk është dëmtuar në parametrat e saj, por në të kundërt është respektuar padiskutim fizibiliteti. Madje, me përgjegjësinë e ideuesit dhe projektuesit, ajo është përmirësuar më tej. Mjafton të përmendim, që nga 7 metra rruga do të jetë 9 m, në krahasim me ç'ka ka qenë vendosur në studimin e fizibilitetit dhe kjo nuk është pak. Janë bërë gjithashtu përmirësime planimetrike në krahasim me fizibilitetin qoftë, jo aq shumë në segmentin Bulqizë - Ura e Çerenecit, por veçanërisht në segmentin nga Ura e Vashës deri në Bulqizë.

Përsa i përket lidhjes me Klosin, ajo do të precizohet mbasi të pro-

## KRYEMINISTRI BERISHA TAKOHET ME NJË GRUP INVESTITORËSH ITALIANË, TË KRYESUAR NGA SENATORI KARLO BERNINI

Kryeministri Berisha priti në një takim, më 10 korrik 2008, një grup investitorësh italianë përfaqësues të Shoqërisë italiane të kompanive të ndërtimit të rrugëve, të kryesuar nga senatori Karlo Bernini. Investitorët italianë paraqitën projektet e tyre për financimin e autostradës Tiranë-Elbasan, si dhe interesin e tyre për akse të tjera rrugore si atë Thumanë-Rrogzhinë, **Rrugën e Arbërit** apo Aksin e Jugut.



Kryeministri Berisha duke i falënderuar investitorët për interesin e shfaqur në sektorin e infrastrukturës rrugore, i njohu ata me zhvillimet më të fundit ekonomike në Shqipëri, si dhe me rezultatet e reformave të ndërmarra nga qeveria në disa prej fushave më të rëndësishme. Kryeministri theksoi se qeveria që ai kryeson, ka si prioritet kryesor në këtë mandat të saj, ndërtimin e infrastrukturës së rrugëve tetur nga qeveria.

“Duhet të aktivizohet edhe segmenti i fundit në territorin shqiptar, që është ai nga Ura e Çerenecit deri në kufi dhe të nxitet qeveria maqedonase të punojë në drejtim të këtij korridori të rëndësishëm në territorin e Maqedonisë”.

# të jetë një rrugë moderne”

**Aktualisht, një kompanie italiane, ja kam bërë skemën për marrjen e një kredie me afat 11.5 vjet, në mënyrë që këtë kredi t’ja marrë kompania e huaj, e cila është e besueshme në bankat e fuqishme, ndersa Qeveria shqiptare, në këtë rast, garanton këtë kredi. Ne kemi patur dikur një shembull në Shqipëri për këtë. Me kredinë e marrë kompania e huaj ndërton rrugën dhe menjëherë pas ndërtimit fillon shlyerja e borxhit, që bëhet për 11.5 vjet. Imagjini sikur shteti, pa këtë kredi, të merrte përsipër ndërtimin për 11.5 vjet? Do të dukej sikur rruga nuk do të mbaronte kurrë. Në këtë mënyrë ne fitojmë rrugën ndërsa firma fiton interesin e ndërtimit.**

jektohet edhe loti pasardhës nga Urën e Vashës në Murrizë, për të cilën do të bëjmë më të mirën e mundshme. Sigurisht, që lidhja me Klosin nuk mund të kondicionojnë këtë korridor të rëndësishëm, që quhet Rruga e Arbërit. Jo vetëm unë, por cilido inxhinjer që të jetë, qoftë edhe një që nuk ka lidhje me rrugën, do ta kishte në konsideratë.

Megjithatë unë mbetem i hapur për t’i diskutuar këto probleme. Do të ishte më mirë që këto diskutime t’i bënim bashkarisht në një forum tjetër.

**Pyetje: Qeveria Shqiptare, ditët e fundit ka folur për fillimin e punimeve në segmentin Ura e Çerenecit – Peshkopi? Jeni në dijeni të projektit mbi këtë segment dhe a i parashikon ky segment standardet e pjesës tjetër të Rrugës së Arbërit ku po punohet aktualisht?**


**F. Kaba:** Për sa i përket segmentit Ura e Çerenecit-Peshkopi, projekti i së cilës është bërë, nuk jam në gjendje të them me detaje se si, por besoj se edhe ai segment do të marrë ngjyrat e pjesës tjetër. Sigurisht, që aksi kryesor dhe korridori kryesor është ai që kalon nga Tirana drejt në Dibër të Madhe. Por nuk mund të anashkalohet Peshkopia, sepse nuk është vetëm ajo, por do të jetë, në një farë mënyre, i gjithë korridori lindor i vendit, përfshi Kukësin. Shpresoj, që firma që është marrë me atë punë, të ketë bërë më të mirën. Normalisht, Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ministria e Transportit duhet të kishin negociuar me autorët e studimit dhe të idesë së kësaj rruge, por këta t’ia lemë një diskutim tjetër. Shpresoj dhe një herë që të jetë bërë më e mira e mundshme.

**Pyetje: Kohët e fundit po flitet për koncesionet si një alternativë investimi në fushën e infrastrukturës, etj. Madje, vitin e kaluar është miratuar edhe “Ligji i ri për koncesionet”. A është e mundur që “Rruga e Arbërit” të ndërtohet me koncesion, duke lehtësuar financiarisht Buxhetin e Shtetit, i cili do të jetë më në gjendje të financojë vetëm projektin teknik dhe shpronësimet e banorëve nga kalon kjo rrugë? Si**

**pas jush, cili do të ishte varianti ose variantet më të mira të financimit?**

**F. Kaba:** Përsa i përket idesë së mundësisë së funksionimit të një koncesioni për Rrugën e Arbërit, kjo është një temë shumë sensible, jo e re dhe shumë e rëndësishme. Kam disa vjet rresht që punoj në këtë drejtim. Problemi është që një rrugë që përfshihet në një koncesion, bie fjala e tipit BOT (Buiding Operation Transfere - Ndërto Shfrytëzo Transfere) duhet të përgatitet në një mënyrë të tillë, që raporti ndërmjet investimit të ndërtimit dhe të ardhura që vilen nga trafiku, që do të kalojë në këtë rrugë, të jetë i tillë që të justifikohet, pra të jetë me leverdi për investitorin privat. Për fat të keq, në rastin e Rrugës së Arbërit, nga studimi i Fisibilitetit nuk rezulton një gjë e tillë. Atëherë ç’duhet të bëjmë? Bota ka gjetur zgjidhje të tjera, të ngjashme me koncesionet, siç janë projektet që fuqihen PPP (Partneriteti i Sektorit Publik me atë Privat). Çfarë do të thotë kjo? Që në qoftë se kostoja e ndërtimit të kësaj rruge, ta zëmë, është 100 milionë, me koncesionin klasik nuk justifikohet, sepse investimi nuk e shlyen veten për afatet kohore, që kërkon ligji mbi koncesionin. (Të kuptohemi, shifra nuk është kjo, por po e marrim për efekt shpjegimi). Atëherë qeveria, sektori publik, merr përsipër një pjesë

**Përsa i përket lidhjes me Klosin, ajo do të precizohet mbasi të projektohet edhe loti pasardhës nga Urën e Vashës në Murrizë, për të cilën do të bëjmë më të mirën e mundshme. Sigurisht, që lidhja me Klosin nuk mund të kondicionojnë këtë korridor të rëndësishëm, që quhet Rruga e Arbërit**



të investimit dhe kostoja nga 100 zbrit në 50, 60 milionë etj., dhe në këtë mënyrë raporti i investimit me të ardhurat ndryshon dhe investimi bëhet fizibel. Ose mund të përdoret mënyra e kreditimit.

Ka forma nga më të ndryshmet. Këto propozime në mënyrë të vazhdueshme ia kam paraqitur edhe ndonje deputeti dhe kompanive të huaja. Aktualisht, një kompanie italiane, ja kam bërë skemën për marrjen e një kredie me afat 11.5 vjet, në mënyrë që këtë kredi t’ja marrë kompania e huaj, e cila është e besueshme në bankat e fuqishme, ndersa Qeveria shqiptare, në këtë rast, garanton këtë kredi. Ne kemi patur dikur një shembull në Shqipëri për këtë. Me kredinë e marrë kompania e huaj ndërton rrugën dhe menjëherë pas ndërtimit fillon shlyerja e borxhit, që bëhet për 11.5 vjet. Imagjini sikur shteti, pa këtë kredi, të merrte përsipër ndërtimin për 11.5 vjet? Do të dukej sikur rruga nuk do të mbaronte kurrë. Në këtë mënyrë ne fitojmë rrugën ndërsa firma fiton interesin e ndërtimit. Është pak a shumë si një blerje shtëpie që bëhet sot, por duke u përfshirë shteti, interesi nuk është më me 7-8%, por vetëm 3-4%.

Kjo është shumë e leverdishtme për shtetin. Është një ide që ka funksionuar: rruga ndërtohet dhe të gjithë janë të kënaqur, shteti është i kënaqur, firma është e kënaqur sepse merr fitimet e ndërtimit dhe ne fitojmë rrugën shumë shpejt. Është i vetmi korridor në Shqipëri, i cili e justifikon këtë mënyrë financimi. Duhet patur parasysh, se për këtë kërkohet edhe miratimi nga Fondi Monetar Ndërkombëtar, por besojmë se nuk duhet të ketë pengesa, për vetë ecurinë e ekonomisë sonë në këto vitet e fundit.

**Pyetje: Kur flisni për firmën e**

**huaj, mos e keni fjalën për investitorët italianë që para pak ditësh takuan Kryeministrin Berisha?**

**F. Kaba:** Jo. Është një firmë tjetër. Megjithatë, këtu nuk po flasim për një firmë konkrete. Mund të jetë çdo firmë e njohur e besueshme në këtë fushë.

**Pyetje: Kur flisni për trafikun, a mendoni se në këtë rast ai nuk është tregues shumë i qartë, pasi Rruga e Arbërit, për të cilin po flasim, nuk funksionon. Pra, është një aks komplek i ri?**

**F. Kaba:** Sigurisht që e kemi parasysh. Ne kemi pasur edhe eksperiencat të mëparshme, ku konsulentët kanë gabuar me llogaritjen e trafikut. Unë mund t’ju jap një shembull, për rrugën nga Plepat në Durrës deri në Rogozhinë. Konsulenti i huaj llogariti që mbas 20 vjetësh trafiku do të arrinte në 6900 mjete në 24 orë. Mbas 2 vjetësh trafiku arriti 10 mijë mjete në 24 orë dhe tani ka kaluar 14 mijë mjete në 24 orë.

Edhe Rruga e Arbërit do të gjenerojë trafik, padiskutim, dhe ne e kemi patur parasysh në studimin e fizibilitetit, por nuk jemi në gjendje dhe nuk na lejohet që të bëjmë supozime për gjëra që teknika i përcakton dhe parashikon me llogaritje dhe programe që na ofron teknika bashkohore.

**Pyetje: Situata gjeopolitike në Ballkan ka ndryshuar. Kohët e fundit, Maqedonia ka rritur interesin e bashkëpunimi me Shqipërinë. Presidenti Maqedonas Cervenkovski gjatë vizitës së tij të fundit, i kërkoi Presidentit Bamir Topi Portin e Durrësit, ndërsa para pak ditësh Parlamenti Maqedonas hoqi edhe regjimin e vizave me Shqipërinë. Në këtë kuptim, po them se trafiku është i paparashikueshem dhe mund të pësojë rritje shumë të madhe, nga i cili jo vetëm Porti i Durrësit, por edhe ai i Lezhës**

**fiton shumë vlera?**

**F. Kaba:** Sigurisht që po. Këto janë elemente shumë pozitive, që në një farë mënyre janë patur në konsideratë. Kemi bërë edhe studimin e fizibilitetit të rrugës nga Rrësheni deri në Klos dhe Bulqizë. Bëhet fjalë për lidhjen e dy korridoreve, korridorin e Kosovës dhe të Dibrës. Ka përfunduar studimi i fizibilitetit dhe do të bëhet edhe projektzbatimi. Sigurisht që të gjitha këto rrethana gjeopolitike dhe projekte të reja do të ndikojnë shumë pozitivisht, do të kenë një impakt të jashtëzakonshëm pozitiv në infrastrukturën rrugore të këtij rajoni dhe të gjithë vendit.

Ka dhe një problem tjetër: duhet të nxitet qeveria maqedonase të punojë në drejtim të Rrugës së Arbërit. Kjo është edhe detyrë e shtetit shqiptar. Unë personalisht kam bërë çështje e mundur në këtë drejtim. Keshtu bie fjala, duhet të aktivizohet edhe segmenti i fundit në territorin shqiptar, që është ai nga Ura e Çerenecit deri në kufi dhe të nxitet qeveria maqedonase të punojë në drejtim të këtij korridori të rëndësishëm në territorin e Maqedonisë. Kjo është shumë e rëndësishme pasi ato janë mbrapa.

Në qoftë se një firmë e merr përsipër ta ndërtojë për dy vjet Rrugën e Arbrit, sipas idesë që thamë (Partneritet Publik-Privat), atëherë çfarë mund të ndodhë, sepse rruga do të bëhet e vlefshme në territorin shqiptar. Atëherë do të ketë një *botellnek* në Dibër, sepse situata nga Dibra e Madhe deri në Mavrovë dhe Gostivar përfaqëson një rrugë me një infrastrukturë relativisht të dobët, e cila duhet përmirësuar. Nuk ia vlen që të dalësh në Dibër, të shkosh në Strugë dhe të futesh për Kërçovë. Detyrimisht, qeveria e Maqedonisë me nxitjen edhe të qeverisë sonë dhe interesave reciproke, duhet të bëjë më të mirën, që të fillojë planifikimin, sepse ato ecin pak më ngadalë në këtë sens. Faktet kanë treguar që ato kanë qenë të kujdesshëm dhe kanë qenë të saktë nga ato që kanë bërë, por në rastin e Rrugës së Arbrit ato janë jashtëzakonisht mbrapa, duhet të bëjnë maksimumin që ta gjenerojnë pjesën e rrugës në territorin e tyre.

**Pyetje: E fundit, me informacionet që ju keni aktualisht, kur mendoni se do të fillojnë punimet, në atë që do të konsiderohej vërtet Rruga e Arbërit?**

**F. Kaba:** Besoj se shumë shpejt. Kur të dorëzohet projektzbatimi i segmentit Bulqizë – Ura e Vashës - Klos, qeveria, mesa jam në dijeni, ka gati fondet e nevojshme për ndërtimin edhe të këtij segmenti. E njëjta gjë do të ndodhë edhe me pjesën nga Ura e Vashës deri në Tiranë, e cila pret vetem procedurat e tenderimit dhe hartimin e projekt zbatimit, për të filluar nga puna.

Unë jam optimist se qeveria do të mbajë premtimin që u ka dhënë dibranëve dhe ne do ta gëzojmë shpejt këtë rrugë.

**Bisedoi: BUJAR KAROSHI**

Shpronësimet në Rrugën e Arbërit nga Fushë Bulqiza te Ura e Cerencit zënë një sipërfaqe totale prej 37770 m<sup>2</sup> arë dhe 204 m<sup>2</sup> truall. E gjithë vlera e shpronësimeve arrin 6 816 014 lekë ose mesatarisht 50 000 lekë për familje.



## SHENIM

# Shpronësim pa shpronësim

(Vijon nga faqja 1)

Por kur lexon njoftimin publik të Ministrisë së Punëve Publike dhe Transporteve, dallon se këta banorë nuk kanë për t'u shpronësuar ndonjëherë. Të paktën, disa prej tyre, po të kenë durim, vullnet dhe miqësi, edhe marrin ndonjë lekë. Në njoftimin zyrtar, në kolonën shënime, është shkruar "Plotësim dokumentacioni". Sipas sqarimit zyrtar, këta banorë do të shpronësohen "pas miratimit të kërkesës për shpronësim nga Këshilli i Ministrave dhe, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin respektiv të pronësisë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve". Gjë që, e përkthyer në gjuhën e popullit, do të thotë: kurrë!

Dhe faji për këtë, natyrisht, nuk është i gjithi i qeverisë. Në radhë të parë, është i vetë banorëve dhe pushtetit vendor.

Shumë prej fshatarëve nuk kanë preferuar të regjistrojnë tokën e tyre, megjithëse, deri tani, askush nuk ka paguar taksë për të. Por jo vetëm që s'kanë paguar taksë për shtetin, por kanë menduar edhe të marrin asistencë. Sipas ligjit, banorët në fshat që kanë në pronësi tokë arë, nuk përfitojnë asistencë. Kështu, këtu hyn në valle edhe pushteti lokal, nuk e regjistrojmë tokën. Lart në qeveri bëhet korrupsion i madh, ne bëjmë pakëz "korrupsion" të vogël. Tokën e përdorim, nuk e regjistrojmë dhe, nga ana tjetër, marrim atë pak asistencë.

Por, në këtë rast, shuma e shpronësimit për disa prej banorëve është e madhe. Rreth 20-30 prej tyre, nga 141 veta që shpronësohen, përfitojnë një shumë mbi 1 milionë lekë (të vjetra natyrisht), jo pak për banorët e këtyre anëve, të cilët do të bëjnë përpjekjet maksimale të plotësojnë dokumentacionin. Natyrisht, gjatë rrugës do ta "lyejnë rrotën", siç bënë kur morën asistencën, por pjesa tjetër do ta ketë të vështirë. Nuk besoj se Hane Ferit Gjura nga Fushë Bulqiza do të kërkojë të plotësojë dokumentacionin për 18 m<sup>2</sup> dhe të përfitojë tetëmbëdhjetë mijë e tridhjetë lekë (të vjetra). Më e mira për ta do të ishte një tabelë e vendosur në anë të rrugës: "18 m<sup>2</sup> tokë falur Shtetit nga H.F.Gjura". Këtë mund ta bëjë edhe Halit Sulejman Boba... Të paktën regjistrohen si bamirës për "Rrugën e Arbërit".

B.KAROSHI

## Lista emërore e pronarëve që shpronësohen nga ndërtimi i segmentit rrugor **Fushë Bulqizë - Ura e Çerencit**

Emri Atësia Mbiemri	M <sup>2</sup>	Shuma Lekë	Emri Atësia Mbiemri	M <sup>2</sup>	Shuma Lekë
<b>QARKU DIBËR, BASHKIA BULQIZË, FSHATI VAJKAL</b>					
1) Liman Mexhit Voci	156	30732	26) Merjeme Muharrem Balja	255	31110
2) Haki Isuf Dauti	360	70920	27) Hysen Ali Balja	300	36600
3) Sadik Ali Sadiku	200	39400	28) Hysen Ali Balja	300	36600
4) Afrim Hid Sula	138	27186	29) Abdulla Adem Xhafa	80	9760
5) Halit Bilal Sula	90	17730	30) Besim Hamit Gjura	256	31232
6) Hajrie Isuf Sula	90	17730	31) Hane Ferit Gjura	15	1830
7) Faik Hysen Tançi	50	9850	32) Fiqiri Bilal Gjura	160	19520
8) Nimetalie Hysen Tançi	50	9850	33) Kujtim Maliq Kuka	994	121268
9) Ismet Hysen Tançi	50	9850	34) Mustafa Maliq Kuka	1178	143716
10) Kujtim Hysen Tançi	50	9850	35) Muharrem Maliq Kuka	624	76128
11) Hajdar Hysen Tançi	50	9850	36) Shefqet Hasan Daka	1452	177144
12) Rifat Bajram Tançi	100	19700	37) Latif Sulejman Doda	60	7320
13) Ilmi Bajram Tançi	100	19700	38) Selman Tahir Doda	480	58560
14) Dalip Bajram Tançi	125	24625	39) Mehmet Hysen Xhafa	400	48800
15) Shefqet Elmaz Tançi	90	17730	40) Riza Hysen Xhafa	192	23424
16) Mite Bajazit Kola	72	14184	41) Artur Fiqiri Gjura	144	17568
17) Moiz Kamber Tançi	90	17730	42) Lavdie Ali Disha, truall	96	41952
18) Afrim Hid Sula	506	99682			
19) Alfred Besnik Tançi	56	11032	<b>QARKU DIBËR, BASHKIA BULQIZË, FSHATI VALIKARDHË</b>		
20) Alfred Besnik Tançi	48	9456	1) Lime Allushi	244	53192
21) Hysen Jonuz Ceni	72	14184	2) Shefqet Osman Zeneli	704	153472
22) Sulejman Qazim Aliaj	88	17336	3) Osman Selim Zeneli	273	59514
23) Bedri Halit Aliaj	32	6304	4) Idriz Osman Zeneli	620	135160
24) Fatmir Halit Aliaj	32	6304	5) Bajram Hamet Hyka	1200	261600
25) Kapllan Hamit Aliaj	32	6304	6) Lahim Mustafa Zogu	650	141700
26) Roland Destan Aliaj	32	6304	7) Idriz Osman Zeneli	357	77826
27) Qamil Mustafa Sula	64	12608	8) Bujar Mustafa Zogu	463	100934
28) Xhemile Hysen Sula	60	11820	9) B. Pr. Ylli Rakop Hoxha, Gëzim Hasan Hoxha	426	92868
29) Sahade Adem Hoxha	70	13790			
30) Sadie Fasli Sadiku	100	19700	<b>QARKU DIBËR, BASHKIA BULQIZË, FSHATI GODVI</b>		
31) Afrim Hid Sula	30	5910	1) Skënder Tahir Fiku	280	55160
32) Alfred Besnik Tançi	96	18912	2) Ilmi Tahir Fiku	290	57130
33) Diamant Sadik Hoxha	36	7092	3) Muharrem Hamit Fiku	320	63040
34) Zaide Selman Balla	200	39400	4) Ibrahim Hamit Fiku	530	104410
35) Ismail Riza Balla	388	76436	5) Aqif Shaban Fiku	400	78800
36) Hysni Hysen Balla	667	131399	6) Ismail Aqif Fiku	120	23640
37) Hysni Hysen Balla	660	130020			
38) Tushe Mustafa Lika	589	116033	<b>QARKU DIBËR, BASHKIA BULQIZË, FSHATI KRAJKË</b>		
39) Tushe Mustafa Lika	216	42552	1) Ali Ferit Mera	52	12792
40) Kujtim Fadil Ternova	112	22064	2) Ali Bajram Nela	135	33210
41) Tushe Mustafa Lika	220	43340	3) Xheladin Tal Mera	208	51168
42) Kujtim Fadil Ternova	561	110517	4) Ali Ferit Mera	115	28290
			5) Ismail Asllan Kurcani	117	28782
<b>QARKU DIBËR, BASHKIA BULQIZË, FSHATI DRAGU</b>					
1) Pellumb Mehmet Boba	84	9744	6) Xhezmi Ali, Mera	735	180810
2) Pellumb Mehmet Boba	144	16704	7) Dilaver Jaho Hoxha	450	110700
3) Bajram Isuf Boba	130	15080	8) Xheladin Tal Mera	30	7380
4) Isuf Mehmet Boba	240	27840	9) Skënder Ali Mera	45	11070
5) Halit Sulejman Boba	25	2900	10) Dashmir Dilaver Mera	125	30750
			11) Sabri Selim Mera	312	76752
<b>QARKU DIBËR, BASHKIA BULQIZË, FSHATI FUSHË-BULQIZË</b>					
1) Muharrem Hamit Zeneli	495	60390	12) Defrim Hysen Mera	885	217710
2) Gëzim Lahim Zeneli	320	39040	13) Bajram Dilaver Mera	728	179088
3) Shkëlqim Abdulla Gjini	130	15860	14) Beshir Dan Dervishi	1875	461250
4) Hasan Jonuz Kica	70	8540	15) Bajram Dilaver Mera	292	71832
5) Riza Hajredin Kica	300	36600	16) Defrim Hysen Mera	285	70110
6) Hasan Jonuz Kica	383	46726	17) Sabri Selim Mera	255	62730
7) Rifat Seit Kola	210	25620	18) Agim Muharrem Kurcani	687	169002
8) Agron Tahir Kica	256	31232	19) Muharrem Ali Mera	100	24600
9) Hamza Sulejman Kica	40	4880	20) Skënder Ali Mera	135	33210
10) Rabie Hysen Kica	54	6588	21) Mite Sadik Mera	185	45510
11) Bilal Shahin Kola	75	9150	22) Lutfi Shaban Kurcani	85	20910
12) Shëtim Hasan Kola	300	36600	23) Muharrem Ali Mera	18	4428
13) Seit Shahin Kola	192	23424	24) Ilir Ramadan Lami	132	32472
14) Riza Hajredin Kica	131	28182	25) Lutfie Rifat Cani	176	43296
15) Sadete Dile Gjini	72	8784	26) Skënder Ali Mera	126	30996
16) Arben Isuf Kola	120 + 437(truall)	61836	27) Feride Xhemal Beka	108	26568
17) Ramadan Hysen Dedja	450	54900	28) Petrit Shaban Kurcani	80	19680
18) Rexhep Bajram Doga	420	51240	29) Lutfi Shaban Kurcani	85	20910
19) Veli Izet Doga	195	23790			
20) Riza Hysen Xhafa	108	13176	<b>QARKU DIBËR, BASHKIA BULQIZË, FSHATI SOFRAÇAN</b>		
21) Rakip Hysen Xhafa	108	13176	1) Muharrem Mexhit Nuci	60	5040
22) Hysen Ali Balja	300	36600	2) Selim Isuf Cani	306	25704
23) Sadete Dile Gjini	276	33672	3) Muharrem Sadik Cani	345	28980
24) Petrit Ramadan Xhafa	132	16104	4) Bibë Merdan Cani	58	4872
25) Petrit Ramadan Xhafa	900	109800	5) Mexhit Veli Nuci	345	28980
			6) Sadik Jashar Shahini	121	10164
			7) Artur Haki Nuci	169	14196
			8) Ilmi Muharrem Elmazi	450	37800

Nga: Agron TUFA

I pavëmendshëm ndaj asaj çka shkruajnë gazetaret e përditshme a periodike të kryeqytetit (le më fletushkave lokale pa asfarë vlere, drejtuar nga anonimata akoma më pa vlerë), nuk ia vara fort një mesazhi celular, që më bënte me dije se: "Në gazetën "Dibra" ka shpifur për ty një kuksi". Për momentin pata dy habi të vockla kalimtare; e para: - çdo ky farë kuksi-ani në një gazetë me emrin "Dibra"? Dhe e dyta: - si nuk e paskam ditur që ekzistueska një gazetë e tillë? Mandej, thjesht, e fshiva nga mendja edhe kuksi-ani që paskej shpifur, edhe ekzistencën e gazetës me emrin e vendlindjes time ku paskej shpifur ai. Por nuk qe e thënë, se në këtë botë ku rravogjme të kapim rritim dhe hapin e saj të madh, të përzihen nëpër këmbë lloj-lloj rrodhesh, halash, bëzhdielsh e çikërimash, që edhe ato, këmbëngulin të dalin në pah me delirin e tyre tyrfil, kërkojnë me qitë krye, të bien në sy, ta lshojnë thirrjen e tyre të inatosur, ndonëse të përhumbur: - "eëej, na dëgjoni dhe ne... se edhe ne ekzistojmë!". Kështu, gazetën "Dibra", si për të më bindur se kjo "gazetë" mënjëmend ekziston (madje prej 6 numrash), e gjej në kutinë time postare në Fakultetin Filologjik dhe, në një nga faqet e saj, dërguesi kishte nënvizuar titullin e një shkrimi ankestar - "Pse kështu?".

Përpos disa gabimeve drejtshkrimore, përdorimeve të gabuara dhe anormalisht të dendura të shenjave të pikësimit, mbizotëronte, përgjithësisht, teknika e fletërrufëve të dikurshme të kooperativave, përsëritjeve paranojake, klithmave, ububuve, sforcimeve banale për ndonjë shpoti etj, etj. Por mbi të gjitha spikaste në atë fletërrufe lokale mungesa patologjike e mendimit, arsyes, argumentit - gjëra këto fort të rralla për sërën e përvuajtur të atyre që kanë nevojë të ngutshme për arsimim. Me pak fjalë, më zbavit mjaft kjo lloj fletërrufëje, sepse e pandehja si një zhanër të zhdukur që nga "koha e qepës". Si duket, akrepat e orës nuk ecin kudo njësoj në këtë botë jallane: diku shthyen përpara, në pararojë të qytetërimit, e diku tjetër ngecin në vend, duke i shndërruar shkarrashkruet e tyre në ndoca donkishotë me tërë kuptimin qesharak e negativ të fjalës. Poshtë fletërrufësë që shkruar autori në kllapa dhe thonjëza ("Dibra"), ndërsa ndën të, me stilolaps, dërguesi kishte shkruar, si të donte ta nxirrte prej kllapash ku qe struktur emrin e vërtetë të fletërrufësë: *Fatos Daci, nga Kukësi*.

Në fund fare edhe dy fjalë për atë që mund të mendohet se përbën mendimin qëndror të fletërrufësë. Meqë autori i këtij shkrimi, jo vetëm e krijon dhe e studion letërsinë, por edhe e shqipëron dhe e interpreton atë, ndeshet në vështirësi të posaçme përballë teksteve të fletërrufëve, pasi ato përbëjnë një stilistikë të perënduar tashmë. Mendimet e fletërrufësë ngjanin me atë rakinë e keqe që del pasi kemi marrë të ziejmë prapë bërësitë e shfrytëzuara njëherë (në këso rastesh del një raki e tillë e shpifur që të jep dhimbje të bezdisshme koke).

Shkurt, F. Daci nga Kukësi, shan librin tim, të prezantuar me 13. 06. 2008, me titull "Dibra me sytë e të huajve". Këtë e bën duke akuzuar se:

a) Autori i quan të huaj një sërë

# Si dac shëndreu

## SHENIM I REDAKSISË

*Kur vendosëm të botonim replikën e z. Agron Tufa, u menduam gjatë. Jo se ishte hera e parë dhe s'dinim çfarë të bënim, por edhe më parë, në drejtim të gazetës "Rruga e Arbërit" kanë ardhur shumë shkrime me replika kundër botuesit të gazetës "Dibra". Por ne nuk i kemi botuar, jo se nuk na e mban apo kemi frikë, por sepse ato nuk pajtoheshin me frymën dhe misionin e gazetës "Rruga e Arbërit". Kështu që ato i kemi kyçur në arkivin e korrespondencës apo inbox-et e emailëve.*

*Botuesi i gazetës "Dibra" ka sulmuar e këshilluar bashkëpunëtorët tanë, miqtë, dashamirësit dhe lexuesit e gazetës që ta ndërpresin dhunshëm komunikimin me "Rrugën e Arbërit", por ne dhe bashkëpunëtorët tanë nuk jemi marrë me të. Në këto sulme, botuesi në fjalë, ka shpifur e sharë Shoqatën e Intelektualëve Dibranë dhe gazetën me lloj-lloj epitetesh, por ne kemi bërë të pantesuarin dhe i kemi anashkaluar.*

*Qëllimi i gazetës "Rruga e Arbërit", që në ditën e parë, ka qenë krijimi i hapësirave për komunikim mes Dibrës dhe hapësirës tjetër shqiptare, ku punojnë e jetojnë dibranët, për t'u kthyer në një urë komunikimi e integrimi. Rruga për të arritur atje është e gjatë dhe e pambarim, por ne do të rrisim shpejtësinë e komunikimit, që brezat që vijnë pas ta kenë më të lehtë rrugën...*

*Këtë rrugë të integritit nuk mund ta bëjmë vetëm, por kur e kemi nisur kemi qenë pak, por tani radhët tona po shtohen në autostradën e zhvillimit. Në këtë rrugë ka vend për të gjithë, pa i bërë hije njëri-tjetrit, por, përkundrazi, duke u mbështetur tek njëri-tjetri për t'u bërë më të fuqishëm.*

*Ne e kemi dorën të shtrirë edhe për botuesin e gazetës "Dibra", që edhe ai të vazhdojë të ecë përpara, krah për krah, jo për t'i bërë karshillëk njëri-tjetrit. Dibra është kaq e madhe, sa as 100 gazeta nuk do t'i mjaftonin...*

emrash të shkencës e kulturës shqiptare, të njohur e të panjohur, dibranë e jo dibranë.

Ja se si e hedhim poshtë një shpifje kaq naive e të patalentuar të Dacit legal apo anonim: Daci ngatërron qëllimshëm titullin e librit "Dibra me sytë e të huajve", me sesionin shkencor mbi tematikën e historisë dhe etnokulturës së Dibrës.

b) Daci me një manipulim të trashë përpiket të kundërshtojë konceptin tonë mbi librin, duke pretenduar se ky koncept u heq të drejtën dibranëve të shkruajnë për historinë e tyre (tonë). Ai citon gjëra tjetërpërtjetër nga fjala jonë, por jo thelbin e rëndësishëm, të cilin e kemi shkruar në skicën hyrëse të librit, dhe pikërisht:

"Ky rekonstruktiv apo përkapje e imazhit të Dibrës dhe dibranëve realizohet në këtë libër në dy nivele. Të kuptohemi drejtë: me togfjalëshin "të huaj", këtu cilësojmë jo shqiptarët e trevave të tjera, të cilët janë bashkatdhetarët dhe se përcaktori "i huaj" për ta, nuk ka funksion pejorativ. Më saktë kuptimi i librit "Dibra me sytë e të huajve" që merr në dorë lexuesi, anon tek kuptimi "Dibra me sytë e jodibranëve".

Pse nuk e citon Daci nga Kuksi këtë pasazh? E pra, këtu "inteligjencës" së Dacit i dalin veshët nga torba! Pyesim: ku shkoi gjithë shkumëzimi i Dacit? Thjesht, doli një "fëshe".

c) Megjithatë Daci, pasi ka kapërcyer ujërat e Kukësit dhe përzihet, pa i dhënë kush leje, në punët e Dibrës, na kritikon konceptin tonë, i cili parashtron se, më mirë është të ndërtohet një imazh i Dibrës nga pena neutrale e jodibranëve dhe të huajve, sesa duke folur vetë për Dibrën. Thjesht e shqip, kjo është e drejta ime të mendoj e veproj, si të më teket, pa pyetur asnjë kuksi, qoftë ky dhe F. Daci. Sepse dibranët e kanë ndjenjën e masës, dinë ta kuptojnë drejtë dialektikën e asaj idiomës "A doni më për Belulin?". Si duket, një të tillë e ka të vështirë ta kuptojë ndonjë kuksi. Duket se Daci i bie shapthi për çdo gjë që është shkruar në atë libër dhe bën një monolog epileptik, mu sikur të drejtën për të shkruar për Di-

brën e ka ai dhe vetëm ai! Mu sikur, çfarë mbajnë kufijtë e Dibrës t'i këtë rrethakue me tabela: "Xanë prej F.Dacit"! Po i lë Dacit, me këtë rast, një detyrë shtëpie: - "Pse vallë nuk shkruan edhe ti diçka, si ta mendosh vetë, për Kukësin tënd?"

d) Daci merr pil dhe luan melodramë me veten, kur pyet: "A kanë vdekur dibranët që Dibrës t'ia bëjnë historinë të huajtë?!". Or Daci i prapë, po ta them edhe njëherë si dibran: ne nuk e kemi zakon të flasim për vete, të mburremi e vetëlëndohemi, se nuk jemi onanistë. Gjykojmë se është më mirë të flasin të tjerët për ne dhe jo është shumë e rëndësishme. Nuk na duket e hijshme të dalim nëpër kojshi të rrahim gjoksin, sipas idiomës - "A doni më për Belulin?".

e) "Kush e prishi imazhin e Dibrës që ta ndreqin këta?!", pyet prapë, se i ka hy xanxa Dacit dhe rreshton emra pambarim. Mos kij qederr bre Daci! Të gjithë emrat që ti i ke përmendë, të gjithë kanë gjetë mënyrën fisnike me më falenderue përzemërsisht, dibrançe, si dhe disa qindra të tjerë, dhe vetëm ti o i shkrete po plas nga marazi. Si duket, në këtë pikë, zelli yt për t'u konvertuar në dibran, paska kaluae "ma katolik se Papa", pra, paska dështue fundekrejt.

f) Daci mundohet t'i japë përgjigje vetes, pse duhen besuar citimet e mia dhe të të tjerëve jo, dhe pse duhet besuar Tufa si Dibran dhe të tjerët jo.

Çfarë t'i themi? Daci është ngatërruar kaq lëmsh me gjalmat e veta, sa s'ka zot ta shpëstjellë. E vetmja këshillë që na vjen ndërmend për ta shpëtuar Dacin, është kjo: "Pse e torturon veten, duke bërë pyetje profane që s'ua ke takatin t'u japësh përgjigje?". Pasi të të hapën sytë nga kjo, duhet me urgjencë ambulance të rinisësh arsimimin e ngutshëm, për t'u qartësuar se, pyetje të tilla janë krejt të panevojshme.

g) Apoteozën e marrëzisë Daci e nënshkruan kur thotë: "Ne askujt s'i kemi hyrë në hise dhe nuk i kemi bërë karshillëk. Të tjerët përse hyjnë në punët tona dhe përse na bëjnë karshillëk?". *Bir Selman i nënës, ç'të të qaj më parë!* Këtu ore burra dibranë,

nuk kam më fjalë. Më mbetet të shtrij duart përpara e të them: "Ohoho - valë!". Se harruam krejt: Daci është edhe enciklopedi!!! A e keni parë gjithë atë enciklopedi?! Unë për vete iu shmanga si një gjëjë antisanitare dhe pata burrërinë t'ia them ballas në foltoren e sallës së muzeut gjithësa mendoja, me idenë se kjo do ta ndihmonte Dacin. Pra, krejt ndryshe nga Daci, që u end nëpër sallë, pa më dalë përpara, për t'u kthyer mandej të ngjente penën me vner e të shkruante fletërrufenë e vet. Thonë se brenda "enciklopedisë" së vet ai ka shti gjithë vëllimet e serisë "Yjet e pashuar", gjithë koleksionet vjetore të "Ushtima e maleve" dhe e ka kërryer gjithë atë deng çiqçevetun. Shkurt llaft, i ka kositë rrafsh përtokë gjithë parimet shkencore, gjithë enciklopedistët, madje edhe iluministët e famshëm francezë me Volter, Didro, Helvetius, Holbah etj. Thonë se u qepej dibranëve me enciklopedi në trastë, duke i vënë në siklet, ku janë e ku s'janë, njashtu siç bëjnë katundarët duke shitë gjizën në Pazar.

gj) Fundi i fletërrufësë së Dacit mbyllet me një kushtrim në stilistikën tipike komuniste të denoncimit masiv: "Pra, të gjithë ju, autorët e nderuar të Dibrës, që keni shkruar e keni botuar libra të fushës historike, të cituar apo të pa cituar më sipër, ju ftojme të shpreheni publikisht, ku të doni, nëse e keni prishur imazhin e Dibrës me botimet tuaja, nëse ju keni qeni subjektivë e të skajshëm....".

Pra Daci mjaullin një thirrje të përvajshme për t'i rekrutuar në paçavurën e tij dibranët, që ta ngjyeyjë edhe ata penën në vner si ai, për t'iu kundërvënë Agron Tufës, me yshtje dhe yrish. Por, medet, kjo fantazmë rron vetëm në kaploqen e sëmurë të F. Dacit. Amanet, kujt t'i dhimbset, bani lazëm me e shërue!

\* \* \*

Është e habitshme se si duke shkruar një fletërrufe kundër një autori dibran, një libri mbi Dibrën dhe një aktiviteti shkencor me përmasa kulturore kombëtare për Dibrën, ky Daci ynë që ka kapërcyer ujën që ndan Dibrën nga Kukësi, shan e shpif, shpif e shan dhe vetëm në këtë mënyrë, pa e kuptuar as ai vetë, vizaton autoportret e vet të saktë, ashtu siç është. Nëpërmjet këtij autoportreti ne njohim të gjitha mllefet, zilitë, kompleksitetet inferiore dhe sidomos - brengën e asaj pulës, që deshi njëherë ta bëjë vezën të madhe sa të patës, mirëpo... plasi andej nga del veza. Ai vepron si ajo miza që pështyn dhe ndot në çdo gjellë ku prek.

Ne Dibranët e kemi dashur dhe e kemi nderuar mikun si askush tjetër; e kemi ulë në krye të vendit, por kur nuk e kemi pranue zot shpie. Edhe dacit, kur na përzihet në sofër, nuk i biem me lugë. Thjesht mundohemi me i nxjerrë ndonjë kockë mënjane, mos me na prishë bukën. Kurse dacin e prapë e përzëmë me një shqelm jashtë dere, e lëmë të mjaullijë e të ngjiret me shpurrëza në dëborë si ndëshkim, me sytë e hapun-duçek, duke gërvishtun derën ankueshëm. Prandaj ka mbetë ajo shprehja "si dac

Përpos disa gabimeve drejtshkrimore, përdorimeve të gabuara dhe anormalisht të dendura të shenjave të pikësimit, mbizotëronte, përgjithësisht, teknika e fletërrufëve të dikurshme të kooperativave, përsëritjeve paranojake, klithmave, ububuve, sforcimeve banale për ndonjë shpoti etj, etj. Por mbi të gjitha spikaste në atë fletërrufe lokale mungesa patologjike e mendimit, arsyes, argumentit - gjëra këto fort të rralla për sërën e përvuajtur të atyre që kanë nevojë të ngutshme për arsimim.

shëndreu".

Çfarë të them për Dacin tonë, që don me na u heqë ma dibran se dibranët? Aq më tepër unë? E ndjeja si detyrë përpara lexuesve të mi të shumtë në Dibrë dhe në gjithë Shqipërinë, thjesht t'i sqaroja se fletërrufeja e Dacit keqinformon ligësisht, se libri "Dibra me sytë e të huajve" është një libër i veçantë kulturologjik dhe etnografik, se nuk merr përsipër as të shkruajë historinë e Dibrës, e mo' zo' ma keq, nuk merr përsipër të jetë "enciklopedi". Ai është një riprezantim i repertorit tonë kulturor, historiografik, etnopsiqik, zakonor e mental, që vlen si për dibranët që jetojnë brenda dy Dibrave, si për dibranët e shpërndarë në trojet shqiptare dhe jashtë tyre, kodo qofshin ata. Ky libër është llogaritur të zgjojë një vëmendje specifike edhe për lexuesit e studiuesit jodibranë, e madje edhe të huaj. I falenderoj lexuesit e shumtë që interesohen për këtë libër dhe më dërgojnë mesazhet dhe përshtetjet e tyre. Falenderoj anëtarët e shoqatës "Lidhja e Intelektualëve Dibranë" që më kanë mbështetur moralisht dhe kanë shpenzuar lekë e jo llafe në realizimin teknik të librit. E ndjeja si detyrim për vendlindjen time këtë libër, bashkë me guidën hyrëse dhe interetuese prej 82 faqesh, e cila është një ftesë hyrëse në logjikën etnokulturore të librit, duke iu referuar një lexuesi me mendje të shëndoshë, dhe jo psikopatologjive të sëmurë. Sipas këtij Dacit, asgjë nuk mund të jetë e mirë, po qe se nuk ka futur hundët dhe ai.

Për F. Dacin dhe flëtërrufenë e tij kundër meje, mendoj se duke ua sqaruar, u zbavitëm boll. Tani, para se të ndahemi, kam edhe një kritikë (autokritikë) për veten time, të cilën mund ta shpreh vetëm në stilin e Faik bej Konicës:

"Unë, që kam mbaruar katër universitete, që flas, lexoj e përkthej nga disa gjuhë të huaja, që botoj veprat e mia në disa gjuhë e marr çmime kombëtare e ndërkombëtare, që ligjëroj në auditorë shqiptarë e të Europës, unë, që kam polemizuar në shtypin e huaj me fakte e logjikë shkencore tezat e padrejta antishqiptare nga Moskagjer në Paris, unë pra, më mirë të marr të ha një kovë m... se sa të merrem më me fosile primitive si F.D, - antropoidë që i ka harruar edhe evolucionin, edhe diktatura".

Funksionimi si duhet i vendkalimeve kufitare ekzistuese dhe hapja e vendkalimeve të reja kufitare do të mundësojë qarkullimin komod të njërëzve, ideve, mallrave dhe kapitalit, si të vetmen mundësi për një zhvillim dhe mirëqenie...

aktualitet

## LIBERALIZOHEN VIZAT MES MAQEDONISË DHE SHQIPËRISË

## Shpresë e mirëqenies ndërkuftare

Nga: REXHEP TORTE

Miratimi ditë më parë nga Parlamenti i Maqedonisë i Ligjit për liberalizimin e vizave mes Shqipërisë dhe Maqedonisë, u prit me entuziazëm në tërë zonat kufitare që lidhin Shqipërinë dhe Maqedoninë.

E përditshmja "Fakti", me shumë se 100 artikuj të botuar deritani, është i vetmi medium mbarëshqiptar që më së shumti e ka rrahur problemin e kufirit dhe ka sensibilizuar arritjen sa më të shpejtë të liberalizimit të vizave.

Kjo aqë më shumë sepse ky kufi liberalizohet për herë të parë pas 95 viteve.

**Kufiri i vendosur forcërisht**

Pas Kongresit të Berlinit në vitin 1878, pas shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë në vitin 1912, hordhitë gjakatare serbe ua mësyen trojeve shqiptare me luftime të pabarabarta, të ashpra e të gjata me popullatën vendase, duke djegur, vrarë e plaçkitur dhe duke vendosur edhe kufirin në thellësi të tokave denbabaden shqiptare.

Kufijtë shqiptarë janë vendosur, pa vullnetin e popullatës vendase, pa u përfillur fare as edhe një kriter gjeostrategjik, por vetëm me insistimin hegjemonist ruso-serb dhe me mbështetjen e padrejtë të Konferencës së Ambasadorëve në Londër në vitin 1912/13, e me konfirmimin edhe në Konferencën e Paqes në Paris në vitin 1919/20.

Kufijtë shqiptarë janë vendosur me dhunë. Kufiri për ne shqiptarët është sinonim i vuajtjeve. Trojet tona i ngjajnë mollës së kafshuar nga veriu, nga lindja e nga jugu. Aty ku është kafshuar molla e trojeve tona, aty është vendosur kufiri. Ata që e kafshuan mollën e trojeve tona, hëngrën atë copë molle dhe aty vendosën kufirin. Sa e shëmtuar është kjo përrallë e gjallë, kjo përrallë e trishtueshme. Askund në botë nuk ka kufi kësaj për nga konfiguracioni, askund në botë nuk gjen mollë trojesh të kafshuar nga pesë palë dhëmbë grabitësish, secili më i vrazhdë se tjetri.

Liberalizimi i vizave mes Shqipërisë dhe Maqedonisë dhe lejimi që banorët e dy anëve të kufirit të mund ta kalojnë kufirin me dokumente identifikimi imponon nevojën e hapjes së më shumë pikave doganore.



Dogana e Bllates-Maqedoni

**MAQEDONI, SHQIPJA GJUHE ZYRTARE**

Parlamenti maqedonas votoi të shtunën, 26 korrik 2008, ligjin për përdorimin e gjuhës shqipe si gjuhë zyrtare. Në të gjitha komunat ku shqiptarët përbëjnë më shumë se 20% të popullsisë, gjuha shqipe do të jetë e zyrtarizuar. Gjithashtu, deputetët shqiptarë mund ta përdorin shqipen në mbledhjet e komisioneve parlamentare. Të gjitha ligjet dhe aktet nënligjore do të jenë edhe në gjuhën shqipe.

Gjuha shqipe do të përdoret edhe në komunikimin me qeverinë, në polici dhe në pushtetin gjyqësor.

Ky është vendimi i dytë i rëndësishëm i parlamentit maqedonas gjatë kësaj jave, pas atij të heqjes së regjimit të vizave me Shqipërinë.

Plagët dhe gjëmët e kufirit mund t'i ndjejë vetëm ai që jeton pranë dhe që e ka përjetuar kufirin. Kuptimi i fjalës kufi, ta ftoh shpirtin, të shtyn të mendosh e të ndjesh një cak të fundit, vend prej ku nuk mund të kalosh lirish, kur të duash e sa të duash

**Kufiri që shkatërroi Dibrën e Madhe**

Shembull tipik për dëmtimin e kufijve shqiptarë është edhe Dibra. Vendimet absurde të këtyre dy konferencave ndërkombëtare e ndanë Dibrën dhe sofrën dibrane më dysh. U nda Dibra e Madhe nga trugu stërgjyshor Shqipëria dhe iu dhura Maqedonisë, ndërsa Dibra e Vogël-Peshkopia mbeti në shtetin amë Shqipërinë.

Shkrimtarja amerikane Rouz Uajlder aso kohe, shkruan se, "Dibra iu muar Shqipërisë siç nxirret me thikë sythi i një patateje. Ndërsa vetë reformatori serb Dimitrije Tucoviq, duke përshkruar vendosjen e këtij ku-

firi, shkruan, "Kjo shkëputje bëri të ndahet bujku prej arës, bagëtia prej kullotës, fshati prej mullirit, blerësi dhe shitësi nga tregu, duke i prerë tërë burimet e jetës".

Para se të vendosej ky kufi famëkeq, Dibra e Madhe ishte qendër shumë e zhvilluar dhe e rëndësishme zejtare, tregtare dhe kulturore dhe quhej "Stamboll i Vogël". Ky qytet përbënte nyjen kryesore të tregut unik shqiptar qoftë nga Durrësi për në Sofje, qoftë nga Selaniku për në Manastir e Kosovë.

Ky kufi vazhdoi të jetojë edhe pas Luftës së Dytë Botërore, si perde e hekurt për shqiptarët, sepse shumicën dërmuese të popullatës në dy anët e kufirit e përbëjnë shqiptarët. Gjysëm shekulli i sistemit monist nuk lejonte as zogjtë të kalojnë përtej kufiri. Familjeve të ndara shqiptare edhe pse dëgjonin tingujt e daullës për dasëm dhe gjëmët e vajin për vdekjet, nuk u lejohej për asnjë çast ta kalonin kufirin. Kështu gjenerata të tëra vdiqën pa u parë me të afërmit e tyre

përtej kufirit.

**Demokracia lëkund i kufirin**

Më 9 qershor të vitit 1992, ditën e Festës së Bajramit. Afër 300 mijë banorë të dy zonave kufitare të Dibrës së Madhe dhe Prefekturës së Peshkopisë, që më shumë se kushdo tjetër ndjenë thellë pasojat e bllokimit pesëdhjetëvjeçar, u takuan u përqaftuan dhe u çmallën me gëzim në buzë dhe me lot në sy. Atë ditë nuk kishte dorë gazetari e dorë shkrimtari që nuk dridhej kur përshkruante atë atmosferë të bashkimit të popullit dibran.

Pas kësaj u nënshkruan edhe shumë protokolle dhe marrëveshje për regjimit kufitar, por që për fat të keq në vazhdimësi u zvarritën dhe nuk u zbatuan si duhet.

Vendimi i Qeverisë maqedonase në tetor të vitit 1998, me të cilin prashikohej që për ushtrimin e kontrollit fitosanitar të bimëve, të produkteve të bimëve, të preparateve për mbrojtjen e bimëve gjatë importit të shfrytëzohet vetëm pika kufitare e "Qafë Thënës", ishte i dëmshëm sepse e përfjashtonte vendkalimin kufitar të "Bllatës" edhe pse në dy anët janë shpenzuar mjete të mëdha financiare dhe ka mundësi që të kryhen të gjitha shërbimet doganore.

Më 15 qershor të vitit 2000, tre vite pas nënshkrimit, filloi zbatimi i Marrëveshjes për qarkullimin e vogël

kufitar ndërmjet Shqipërisë dhe Maqedonisë për banorët e zonave kufitare deri 10 kilometra thellësi në dy anët e kufirit. Sipas kësaj marrëveshje banorët e dy anëve të kufirit pa vizë e pa pagesë, mund ta kalojnë kufirin e të qëndrojnë në anën tjetër dy herë në muaj nga 24 orë. Për ndjekjen e zbatimit të kësaj marrëveshje ishte themeluar një komision i përzier mes dy shteteve, i cili nuk u takua asnjëherë edhe pse ishte e nevojshme zgjatja e ditëve të qëndrimit, sepse 24 orë qëndrim nuk mjaftonin as për ceremonitë dasmore dhe as për ato mortore.

**Lypsen më shumë vendkalime kufitare**

Liberalizimi i vizave mes Shqipërisë dhe Maqedonisë dhe lejimi që banorët e dy anëve të kufirit të mund ta kalojnë kufirin me dokumente identifikimi imponon nevojën e hapjes së më shumë pikave doganore. Aktualisht mes Shqipërisë dhe Maqedonisë ka tre vendkalime kufitare, ai i Qafë Thanës, Tushemishtit dhe Bllatës.

Funksionimi si duhet i vendkalimeve kufitare ekzistuese dhe hapja e vendkalimeve të reja kufitare do të mundësojë qarkullimin komod të njërëzve, ideve, mallrave dhe kapitalit, si të vetmen mundësi për një zhvillim dhe mirëqenie sa më të shpejtë të zonave kufitare e më gjerë, për ta përmirësuar sadopak padrejtësinë që historia ua imponoi këtyre zonave kufitare.

## Ja cilat janë ndryshimet për të marrë patentën e makinës

Me datë 24.09.2007, Parlamenti shqiptar miratoi ligjin nr.9808 "Për disa ndryshime në Kodin Rrugor të Republikës së Shqipërisë". Ndryshimet në Kodin Rrugor të realizuara me ligjin e mësipërm përfshijnë dhënien e kope-tencave policisë bashkiake për ndëshkuar drejtuesit e mjeteve që parkojnë në vendet e ndaluara brenda territorit që kanë në administrim, detyrimin, që drejtuesit e automjeteve në rrugët interurbane të lëvizin vetëm me dritat e shkurtura të ndezura, kurse motomjetet duhet që ti kenë të ndezura dritat e shkurtura gjatë lëvizjes në të gjithë kategoritë e rrugëve (urbane dhe interurbane). U ndryshua mënyra e testimit të kandidatëve për drejtues mjeti dhe funksionit të autoshkollave për përgatitjen e kandidatëve për drejtues mjeti. Kanë ndryshuar edhe disa përmasa gabarite të mjeteve.

Nëse pjesa më e madhe e këtyre ndryshimeve u vunë në jetë menjëherë, ndryshimet në testimin e kandidatëve dhe mënyrën e përgatitjes së kandidatëve për drejtues mjeti nga autoshkollat vetëm pas 10 muajsh.

Cilat janë ndryshimet që janë bërë në marrjen e patentës?

Për ta kuptuar më qartë po shpjegoj si ka qenë deri më tani dhe si është bërë:

1. Që të rregjistroheshe në autoshkollë për t'u përgatitur si kandidat për drejtues mjeti, duhet të dorëzohet në zyrat e Drejtorisë Rajonale të Shërbimit të Transportit Rrugor ose në një autoshkollë të liçensuar, pasi të kesh mbushur moshën 18 vjeç këto dokumenta: Çertifikatë personale me fotografi, raport mjeksor nga komisioni mjeko ligjor se je i aftë për të drejtuar mjet, vërtetim të qëndrës së banimit, dëftesën shkollore

se ke mbaruar arsimin tetëvjeçar ose edhe me të lartë, vërtetim nga gjykata se nuk je në proces gjyqësor, vërtetim nga prokuroria se nuk je në proces hetimor, fletë analizën që tregon grupin e gjakut dhe 4 copë fotografi, të gjitha këto të marra tre muajt e fundit. Ndryshimi është se tanimë nuk kërkohet dokumenti shkollorë, vërtetimi i prokurorisë dhe i gjykatës.

2. Më parë, kursi i teorisë dhe praktikës zhvillohej njëkohësisht dhe zgjaste jo më pak se 36 ditë, testimi bëhej fillimisht i teorisë, më pas i praktikës dhe lejohej edhe brenda ditës të testohesh për teorisë dhe praktikën, por kishte të drejtë që teorisë dhe praktikën ta jepje deri në tre herë brenda një viti (veç e veç) në qoftë se klasifikohesh mbetës në dy testimet paraardhëse, nëse nuk e fiton të drejtën për tu pajisur me lejedrejtimin brenda një viti dety-

roheshe të rregjistroheshe nga fillimi në autoshkollë. Tanimë, kursi i praktikës nuk mund të zhvillohet pa mbaruar kursin e teorisë dhe pa u klasifikuar kalues në testimin teorik. Vetëm pasi të kesh fituar testin e teorisë, ke të drejtë të fillosh përgatitjen praktike për drejtues mjeti. Testimi i teorisë lejohet deri në 5 herë brenda një viti në se nuk klasifikohesh fitues në testimin paraardhës, po kështu testimi i praktikës lejohet deri në pesë herë brenda një viti pasi je klasifikuar fitues në testimin e teorisë. Kjo periudhë mund të zgjasë deri në dy vjet, nëse nuk klasifikohesh fitues brenda dy vjetësh, detyrohesh të rregjistrohesh nga e para.

3. Programi i teorisë dhe praktikës nuk ka ndryshuar, bazë për të mësuar teorisë është Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë dhe aktet në zbatim të tij, të trajtuara në librat "Manuali i drej-

tuesit të mjetit për lejedrejtimin e kategorisë A dhe B", "Manuali i drejtuesit të mjetit për lejedrejtimin e kategorinë C, D, BE, CE dhe DE", "Manuali i Edukatës Rrugore dhe teknikës për drejtimin e motorit dhe çiklomotorit".

4. Kuptohet, tanimë periudha e përgatitjes shtrihet më gjatë në kohë, pasi nuk lejohet që përgatitja teorike dhe praktike të zhvillohen njëkohësisht, nuk lejohet që testimi i praktikës dhe teorisë të bëhet brenda një dite, qytetarët duhet të paraqiten në autoshkollë veç për teorisë dhe veç për praktikën. Nuk lejohet që të fillohet guida e praktikës pa fituar testimin e teorisë nga komisioni shtetëror përkatës. Qytetari për të marrë patentë, duhet të paraqitet tek komisionet e testimit (provave) jo më pak se 2 herë dhe në rast se nuk klasifikohet kalues deri në 10 herë brenda 2 vjetësh.

DEMIR OSMANI

Jo vetëm dibranët që erdhën nga barbarizmat serbe, por dhe më vonë, ato që vinin për tregti këtej vinin dhe trokisnin në portën më të parë. Tre ditë e bënin këtë rrugë të gjatë e të lodhshme...

Nga: SHAQIR SKARRA

## Trokitje në mëhallën e dibranëve

Mbrëmja ra dhe dritat u ndezën edhe në skutat më të largëta të metropolit. Së bashku me Hasan Lekën e kisha lënë të takohesha tek Hotel "Tirana", fundja dhe rruga e Dibrës këtu nis. E kisha menduar qysh herët që ta shkëlja më këmbë këtë rrugë, kisha biseduar dhe me Ilir Strazimirin dhe Avni Dibrën, të dy dibranë të hershëm, por nuk më ishte bërë për mbarë. E, sonte, këtë natë të freskët qershori, do të ecnim përgjatë kësaj rruge bashkë me Hasanin, do të trokisnim edhe në ndonjë portë avllie në qoftës e nuk u kishte rënë plani rregullues. Hasani kishte dalë më shpejt dhe më priste pikërisht aty ku kishim lënë të takoheshim.

- Nuk di, por sa herë që nisem kësaj udhe ndjej mall, - nisi bisedën Hasani. Është e vetmja rrugë që jo vetëm bashkon Dibrën me Tiranën më shkurt, por mbart në vetvete dhe histori. Histori të dhimbshme, bile. Këndej zbritën karvanet e para nga Dibra në reprezaljet serbe në vitin 1913. E portat e avllive u hapën për dibranët nga tiranasit, duke u bërë kështu vëllezër trojesh si i thonë fjalës. Ato shtëpitë e vogla me qerpiç u ndanë përgjysmë për vëllezërit dibranë. Tiranasit i hapën portat kat e kat dhe për këtë nuk u penduan asnjëherë, bile edhe sot pas kaq vitesh shprehen:

- Lum kush ka një komshi dibran. Lum ai që ka lidhë miqësi me dibranët dhe këto miqësi nuk janë të pakta tashmë. Ne nuk e kemi përjetuar atë periudhë, por kur pamë me sytë tanë në vitin 1999 kosovarët ngarkuar me plaçka dhe fëmijë nëpër zetora të kalonin Morinin, imazhi i viteve të shkuara na erdhi më pranë e kujtesa na u ngjall si diçka tragjike që ka përjetuar vendi ynë.

Rruga është e ngarkuar me makina, saqë dhe trafiku herë-herë blloket. Makinat bëjnë garë me njëra-tjetrën pa u shqetësuar për këmbësorët që janë të shumtë në mbrëmje kësaj rruge. Në të dyja anët e rrugës ka mjaft dyqane, por dhe lokale, të cilat janë të mbushura plot për plot. Shumica rrinë jashtë, meqë është freskët dhe tymosin ndonjë cigare qetë-qetë. Është ndoshta e vetmja rrugë në kryeqytet që ende bashkia nuk ka ndërhyrë fare, siç ka vepruar me rrugën e Durrësit, të Kavajës dhe Elbasanit. Përveç pallateve që janë ndërtuar në të dyja anët e rrugës, asfalti dhe trotualet janë po ato dhe vende-vende të dëmtuara rëndë. Për gjelbërim as që bëhet fjalë. Vitet e fundit Rruga e Dibrës është "pushtuar" edhe nga mjaft dyqane të kinëzëve. Jo vetëm malli kinëz konkurron këtu, por dhe vetë kinëzët janë më të shumtë që bëjnë tregti kësaj rruge. Sapo kaluam selvinë shikojmë një klub të vogël anës rrugës, ku tenda e tij kishte dalë dhe në trotuar. Jashtë një zgarë vazhdonte të pigte qofte që era e tyre kundërmonte që larg dhe brenda tingujt e muzikës popullore ftonin klientët brenda. Tavolinat ishin plot ashtu sikur brenda edhe jashtë. Në një tavolinë qëndronin bashkë Sulejman Tomçini dhe Zeq Agolli. Sulën e njihja si diplomat, por vitet e fundit edhe si përkyes dhe autor i fjalorit arabisht - shqip si dhe shqip-arabisht me



"Mëhalla e Dibranëve" - Foto: Bashkim Lleshi

Mëhalla e dibranëve ka një shtrirje të madhe. Arrin deri tek xhamllëku, siç quhet sot. Nga kjo mëhallë e dikurshme fare pak shtëpi kanë mbetur sot. Shumica janë prishur dhe vendin e tyre e kanë zënë palatet shumëkatëshe, por ama fakt është se mëhalla e dibranëve ende dihet se deri ku shtrihet. Kjo mëhallë u ngrit në ato vite të vështira, ku raprezaljet serbe bënë kërdrinë mbi popullsinë e pafajshme në Dibër e tiranasit u hapën portat...

50000 mijë fjalë, i cili pret dita-ditës të botohet. Me Zeqiu ish takuar rrallë, por nuk njihesha mirë. Dija se kishte qenë ambasador i shtetit shqiptar në shumë vende të botës. Pasi na ftuan për kafe u ulëm në të njëjtën tavolinë. Kur na dhanë dorën pashë që dora e Zeqiu dridhej pak.

- Ka pësuar një paralizë, - tha Sula, por tani është më mirë. Del nganjëherë rrallë këndej e çmallemi si miq të vjetër. Zeqiu, si njeri modest, nuk flet fare për vete.

- Për të flet puna e gjatë si ambasador, - nis e tregon Sula, i cili e njihje herët.

- Ja, tek ai pallati shumëkatësh, dikur ka qenë shtëpia e Zeqiu, - vazhdoi bisedën Sula. E kush nuk e mban mend shtëpinë e tij. Ajo kasolle e vogël u bë një nga bazat kryesore të lëvizjes nacionalçlirimtare e Zeqiu edhe pse djalë i vetëm, jo që kapi pushkën e doli malit për liri, por dhe u bë një udhëheqës i kësaj lëvizje. Kjo shtëpi rrinte hapur ditë e natë. Këtu strehoheshin partizanët, por dhe dibranët që vinin nga larg për hallet e tyre në qytet. Zeqiu është nip i Vehbi Dibrës, një figurë që ka bërë emër edhe jashtë Dibrës. Bashkëshortja e tij, Drita Agolli (Strazimir), regjisorja e parë shqiptare.

- Ende e mban mbiemrin e vajzërisë dhe mburret me të, thotë me gjysmë zëri Zeqiu.

Është vajza e patriotit të madh Ismail Strazimir... Vonë u larguam nga miqtë tanë.

Tingujt e këngës së njohur popullore kënduar nga Haxhi Maqellara na ndiqnin nga pas:

"Ne të dy bëmë një mëhallë, që mban sot emrin tonë. Kujtoi Dibrën plot me mallësa e shoh mëhallën tonë..."

Mëhalla e dibranëve ka një shtrirje të madhe. Arrin deri tek xhamllëku, siç quhet sot. Nga kjo mëhallë e dikurshme fare pak shtëpi kanë mbetur sot. Shumica janë prishur dhe vendin e tyre e kanë zënë palatet shumëkatëshe, por ama fakt është se mëhalla e dibranëve ende dihet se deri ku shtrihet. Kjo mëhallë u ngrit në ato vite të vështira, ku raprezaljet serbe bënë kërdrinë mbi popullsinë e pafajshme në Dibër e tiranasit u hapën portat, u falën troje, por dhe i shitën ato me çmime të arsyeshme si dhe ndanë bukën bashkë në të njëjtën sofër.

Megjithëse ishim larguar tingujt e këngës ende na jehonin në vesh: "Unë në zemër fort të du, se si ty nuk gjej në botë

Me dashtë borxhin me ta kthy, asnjëherë nuk ta laj dot..."

Nuk e mohojnë dibranët atë bujari që treguan tiranasit në ato kohë të vështira. Atë që bëri në ato vite Tirana për Dibrën dhe dibranët, e bëmë të gjithë së bashku në vitin 1999 për vëllezërit tanë kosovarë. Sot nuk ka asnjë lloj evidence që të dimë se cilët fise erdhën më shpejt dhe cilët më vonë në Tiranë. Kur e pyesim Hasanin, ai si i zënë në faj ngre supet e përgjigjet:

- Asgjë nuk dihet, por diçka është e vërtetë se ato që erdhën në vitin 1913, shumica janë nga Dibra e Madhe, fundja dhe masakrat dhe reprezaljet atje ishin më të mëdha. Në Tiranë kanë ardhur dhe më vonë dibranët, sidomos në vitet e monarkisë. Mëhalla që quhet sot e dibranëve ka nisur shtrirjen e saj në vitin 1913. Në Tiranë ka mjaft fise dibrane, ku mund të përmendim Pustina e Tërshana, Sharofi e Lëngu, Menzelxhiu e Stërmilli, Dibra e Kodra, Strazimir e Jegeni, Vojka e Pira. E secili nga këto fise e plot të tjerë si këto luajtën një rol kryesor në luftën e gjatë për liri e pavarësi. Pak metra më sipër gjejmë një portë hapur. Një shtëpi e ndërtuar me qerpiç, ende nuk ishte prishur. Oborri ishte i pastër dhe lulet e shumta jepnin një bukuri mahnitëse në këtë mjedis familjar. Hardhia që zbukuronte rrugicën ishte harlisur, duke i shtrirë lastarët e saj cep më cep dhe duke krijuar një tendë të bukur, ku kishte dëshirë të qëndroje nën hijen e saj. Një burrë rreth të gjashtëdhjetave po rregullonte pikërisht hardhinë në oborr.

- Kjo është shtëpia e Mustafa Çekiçit nga Sllatina, - thotë Hasani. Djali i tij, Luani, sapo na pa në portë, e la punën e na ftoi për një kafe në shtëpi.

- Nuk është mbyllur kjo portë edhe në ato vite që kishte pllakosur zija e

bukës apo siç quhet ende në popull si koha e nemces, - nis bisedën Luani dhe jo sonte që nuk na mungon asgjë. Gjyshja e Luanit Havë Puci kishte punuar edhe në kryeministri si punëtore, në kohën kur Noli ishte kryeministër. Ajo portën e shtëpisë e linte hapur natën. Priste dhe përcillte dibranët që vinin nga larg. Më vonë ndërtoi një hotel të vogël pas Pallatit të Kulturës, ku tokën e kishte blerë herët. Hoteli i Havës i thonin dhe këtu flinin të gjithë me çmime tepër të ulëta në krahasim me tregun në ato vite në Tiranë. Po sa ka kjo mëhallë si nënë Hava? Matanë një tjetër shtëpi.

- Është shtëpia e Kadime Lucës (Herra), - thotë Hasani. Kadimja nuk jeton më. Edhe djali i saj Ganiu nuk jeton. Po sa e sa dibranë ruajnë kujtime të bukura për motrën Kadime.

Ajo u kthye në motër e gjithë dibranëve, duke i pritur dhe përcjellë me bujari dhe buzë në gaz. Ndoshta do të mbeteshim në këto rrugica duke trokitur në porta të tjera, por ora kishte ecur dhe ne kishim më rrugë për të bërë. Pak metra më tutje takojmë Islam Sharofin. Ai na kishte parë që larg dhe siç duket ne na priste. Pasi u përshëndetëm na ftoi për kafe, por koha nuk na mjaftonte. Ishim shumë vonë e duhej të largoheshim. Islami është djali i Haki Sharofit, ku mjaft dorëshkrime dhe materiale të këtij patrioti të madh Islami i ka botuar dhe na i ka servurur ne në formë libri.


- Përsëri po mbledh të tjera dorëshkrime dhe them se do t'i botoj edhe ato shumë shpejt. U ndamë me Islamin dhe filluam të ngjiteshim më sipër.

- Këtu në Tiranë çdo gjë është e lidhur me Dibrën dhe dibranët, - thotë Hasani. Ja kjo që po ecim, Rruga e Dibrës i thonë. Këtej jo vetëm dibranët që erdhën nga barbarizmat serbe, por dhe më vonë, ato që vinin për tregti këtej vinin dhe trokisnin në portën më të parë. Tre ditë e bënin këtë rrugë të gjatë e të lodhshme, por ka pasur raste që e kanë bërë edhe brenda ditës. Ja dhe mëhalla e dibranëve që e lamë pas. Më sipër i thonë qoshja e Elezit. Në rrugën e Kavajës ngrihet madhërishtë minarja e xhamisë së dibranit të mençur Dine Hoxha. Mjaft emra nga dibranët kanë bërë emër në histori, jo vetëm në atë të Tiranës, por dhe më gjerë. Mund të përmendim Jashar Menzelxhiu e Haki Stërmilli, Haki Sharofi e Sherif Lëngu, Vehbi Dibra e Ismet Dibra, Faik Ballanca e Sulejman Pitarka, Besa Imami e Drita Agolli, Gëzim Erebara e Adivije Sharofi, ku shqiptarët e njohin nëpërmjet filmit "Skënderbeu" në rolin e Mamicës.

Tek vendi i quajtur "Rruga-Ura" ndaluam. Këtu fillon një rrugë tjetër. Është rruga "Myslim Keta". Pikërisht këtu pritet të fillojnë punimet për ndërtimin e Rrugës së Arbërit! Këtu ka mjaft dibranë dhe shumë prej tyre kanë ngritur bizneset anës rrugës.

U larguam vonë me shpresë për të ardhur përsëri kësaj udhe! Atëherë kur të bashkohet Tirana me Dibrën me ... një rrugë!

Autorët dibranë rikthehen me botime në të gjitha fushat: Zyber Gjoni me guidën mbi bimët mjekësore, Tomor Shehu me guidën mbi shërbimet publike, Abdurahim Ashiku me një homazh mbi mësuesit e shqipes në emigracion...



Nga promovimi i librit: "Kanada" të autorëve Shpëtim Cami dhe Kastriot Frashëri

## KANADAJA, një vend model për zhvillimin e demokracisë dhe të ekonomisë



Në ditën e Kanadasë, me datë 1 Korrik 2008, ora 19.00 në sallën e Muzeut Historik Kombëtar, në një atmosferë festive u organizua promovimi i librit "KANADA" i autorëve Kastriot Frashëri dhe Shpëtim Cami.

Libri është një vështrim i përgjithshëm mbi Kanadanë, në të gjitha aspektet e saj si për gjeografinë, historinë, shtetin, ekonominë, arsimin, kulturën, turizmin dhe emigracionin.

Kanadaja në këtë botim prezantohet si model zhvillimi dhe demokracinë për tu marrë shembull.

Për të botuar këtë libër u motivuam nga mungesa e këtij informacioni, të cilin e kërkuam nisur nga disa vizita zyrtare që kemi bërë në këtë vend, shprehet Shpëtim Cami, bashkëautor i këtij libri. Para disa ditësh me 21 qershor 2008, shqiptarët e Montrealit organizuan një aktivitet të gjere për prezantimin e Shqipërisë në Kanada. Sigurisht ata kanë nevojë të prezantohen si partner dinjitoz para opinionit kanadez dhe të krenohen me vendin e tyre për të qenë të vlerësuar dhe të barabartë me çdo pikepamje.

Dhe ja sot pas dhjetë ditësh ne prezantojmë Kanadanë në Shqipëri nepermjet këtij libri modest. Mendoj se kështu ne jemi krah tyre.

Libri është një support dhe një imazh pozitiv për të gjithë shqiptarët që banojnë atje, është një kontribut në ndihmë të tyre. Kjo ishte një mundësi për t'ju gjendur pranë tyre nga Shqipëria.

Bashkëautorit tjetër Kastriot Frashëri në fjalën e tij tha se të shkruash për Kanadanë ka pafundësi faktesh dhe duhen mijëra faqe por ne u përpoqëm të përmbledhim gjërat më kryesore në këtë shtet të fuqishëm anëtar i NATO-s dhe i G-7 (Shtatë vendeve më të zhvilluara të botës).

Në këtë aktivitet morën pjesë mbi 250 vetë. Diskutantët që moren fjalën dhe folën mbi librin shprehën konsideratat për librin, autorët dhe për këtë shtet mik të Shqipërisë.

Zonja Lindita Nikolla falenderoi autorët për punën e mirë si dhe kontributin intelektual e financiar për botimin e këtij libri me vlera.

Zoti Besnik Bare ndër të tjera tha se vetëm autorë potencialë si

Shpëtim Cami dhe Kastriot Frashëri mund të na sjellin botime të tilla me vlerë për ne të gjithë dhe për brezin e ri në përgjithësi.

Profesori dhe studiuesi i mjedisit Sazan Guri tha se shembulli i Kanadës edhe në fushën e mjedisit është një vlerë e madhe për vendin tonë.

Zonja Ludmira Bozgo e përmluar u shpreh se e ndjeva përsëri Kanadanë sot në këtë mjedis dhe në këtë libër dhe u kujtoi të pranishëm se Kanadanë e kishte atdhe të dytë të saj.

Arjana Shutku, gjithashtu vlerësoi punën e autorëve si një kontribut të çmuar për mardhëniet midis dy vendeve tona mike.

Griselda Doko që ka qenë studente dhe qytetare e Kanadasë tha se një pjesë të Kanadasë tanimë e kam në bibliotekën time dhe këtë mundësi ma dhanë autorët e këtij libri Shpëtim Cami dhe Kastriot Frashëri.

Diskutimi vazhdoi larg akademizmit në koktejin e organizuar me pjesëmarrjen e të pranishmëve, mediave dhe gazetarëve.

Korresp. "Rruga e Arbërit"

## "59 bimë mjekësore të Dibrës"

Manual për vjelësit, grumbulluesit dhe blerësit e bimëve mjekësore dhe aromatike, mbështetur në parimet e vjeljes së qëndrueshme, ruajtjes së ekosistemit dhe prodhimit organik e jo organik

Rrethi i Dibrës dallohet për një florë spontane të pasur si në sasi, llojshmëri dhe sidomos në cilësi, pasi bimët tona janë afro bio. Grumbullimi i bimëve mjekësore dhe aromatike në Shqipëri dhe veçanërisht në Dibër ka një traditë disa dekadash. Rrethi i Dibrës i marrë në tërësi përfshin më shumë se 1000 grumbullues vjetorë.

Për një vjelje dhe grumbullim të qëndrueshëm të bimëve mjekësore, pavarësisht nga përpjekjet e bëra deri tani nga institucione e individë të ndryshëm, ndjehet nevoja e pasqijes me njohuri dhe libra apo manuale



që trajtojnë çështje të tilla. E parë në këtë sens, SNV-Organizata Holandeze për Zhvillim/Dibër, Shoqata e Bimëve Mjekësore "Mediflor" me drejtues z. Zyber Gjonin dhe Grupi i Zhvillimit të Bimëve Mjekësore Dibër, menduan se botimi i një manuali, i cili pasqyron eksperiencën

Autor: Zyber Gjoni, Kryetar i Shoqatës "Mediflor", Dibër  
Ndihmuan: Federata e Pyjeve dhe Kullotave, Dibër  
Mbështeti financiarisht: SNV/Dibër  
Realizoi botimin: Botimet "m&b"

disa vjeçare të grumbulluar në këtë fushë, do të orientojnë dhe bindë më mirë vjelësit dhe grumbulluesit për një trajtim më të qëndrueshëm të bimëve mjekësore.

Manuali i hartuar është ndarë në dy pjesë: pjesa e përgjithshme dhe pjesa e përshkrimit të bimëve. Në veçanti nga trajtimet e mëparshme, është parë me interes pjesa që trajton bimët mjekësore duke i ndarë ato sipas pjesës që shfrytëzohet, pavarësisht nga trajtimi i parimeve të përgjithshme. Manuali përmban 59 bimë mjekësore.

Në këtë manual vërtet nuk përshkruhen detaje të hollëshme shkencore, por ky punim përbën bazën e një pune të mëtejshme që do të vazhdohet në periudhën në vazhdim, për të bërë të mundur rezistencën dhe furnizimin e tregut.

### BOTIME TË AUTORËVE DIBRANË

ABDURAHIM ASHIKU / Rilindasi e kohës sonë



"Rilindasi e kohës sonë" është një përmbledhje publicistike mbi veprimtarinë e mësuesve të shqipes në botë. Menjëherë pas botimit, më 17 korrik, libri u promovua në Athinë dhe më 22-23 korrik në Strugë, ku ishin mbledhur më shumë se 100 mësues nga e gjithë Evropa, dhe nën kujdesin e Ministrisë së Arsimit të Kosovës dhe Ministrisë së Arsimit dhe Shkencave të Shqipërisë, u diskutua mbi strategjinë e arsimit të fëmijëve shqiptarëve në Evropë.

Libri trajton probleme të kësaj natyre, shqetësime të mësuesve dhe prindërve në gjithë Evropën si dhe mënyrat e rrugët që duhen ndjekur, në mënyrë

që gjuha dhe arsimit shqip të mësohet nga shqiptarët kudo që jetojnë dhe punojnë.


Libri, nga ana tjetër, është një homazh për gjithë mësuesit shqiptarë në Greqi, të cilët, pas punës së përditshme në emigracion, gjejnë kohën të mësojnë falas fëmijët e emigrantëve, duke qenë kështu Rilindasi e kohës sonë, nga ka marrë edhe titullin libri. Libri është një dëshmi se si mësuesit shqiptarë në Greqi kanë marrë iniciativën dhe po organizojnë mësimin e shqipes atje, natyrisht pa mbështetjen e qeverisë shqiptare, në mënyrë fëmijët e emigrantëve të kenë mundësinë të mësojnë shqip. Libri, nga ana tjetër, është edhe një udhërryfes për autoritetet shtetërore të arsimit, për mënyrën dhe rrugën se si mund të ndërtohen politika arsimore në ndihmë të emigrantëve.

Libri është botuar nga shtëpia botuese "m&b" dhe kushton 1200 lekë.

TOMOR SHEHU / Si të ... 2008


Botimi i përgatitur nga Tomor Shehu dhe i mbështetur financiarisht nga USAID është një udhërryfes për qytetarët. Botimi i një guide të tillë si kjo përbën një moment lehtësimi për të gjithë ata qytetarë që kanë nevojë për shërbimet publike. Ajo është e thjeshtë, tregon dhe udhëzon se si qytetarët ta marrin sa më lehtë dhe në mënyrë korrekte shërbimin e administratës. Në këtë guidë janë përfshirë udhëzime për marrjen e shërbimeve që nga bashkia, ministritë, doganat, tatimet, sigurimet shoqërore, gjykatat, posta, ujësjellësi, telefonia, etj.

Duke e përdorur atë qytetarët kanë më shumë mundësi të shpëtojnë prej praktikave korruptive të zyrtarëve, të humbin më pak kohë dhe të orientojnë drejt e në zyrat që ofrojnë shërbimet e kërkuara. Ky libër është botim i Qendrës për Transparencë dhe Informim të Lirë, mbështetur nga USAID, shtypur në shtypshkronjën e shtëpisë Botuese "GEER" dhe kushton 600 lekë.



MEVLUD BUCI / Prova shenjtërie

"Prova shenjtërie" është pasqyra e shpirtit të shenjtëruar. Ky libër i shkruar thjeshtë e me frymëzim ka një tematikë të pasur me skica, poezi epiko-lirike për shenjtërimin, tekste këngësh me temë për shpirtat hyjnor, gojdhëna popullore, për vendet e njerzitetit e shenjtë, aforizma të krijuara për dritën e shenjtërimin. Autori përqëndrohet në libër tek provat e shenjtërimin, të cilat i pasqyron nëpërmjet prozës e vargjeve duke përshkruar artistikisht e mjeshhtërisht shpirtat e shenjtëruar, shenjtërimin e vendit të bekuar Buzëmadhes, të Dervish Ismailit. Në skicat gdhenden emra dhe ngjarje, jepen mesazhe jete, shenjtërim e dashuri njerzore. Provat e shenjtërisë autori i kërkon dhe i gjen tek gjurmët e vendit të shenjtë, tek shpirtat njerzor, tek njerzitetit e thjeshtë, tek njerzitetit shpirt bardhë, për Buzëmadhen e shenjtëruar. Aforizmat e krijuara me mjeshhtëri, fotot të cilat saktësohen me diçitura përkatëse, bëjnë që pa mëdyshje libri të quhet një arkiv hyjnor ku lexuesi i të gjitha moshave gjen prova shenjtërie.



Qazim D. Shehu

**Ramiz Gjini** rikthehet për pushime në Shqipëri, por krahas vizitës në vendlindje dhe takimeve me miqtë që si harron dot, gjen kohë edhe të botojë tregimet e fundit, **subjektet** e të cilave janë sa nga jeta **shqiptare** po aq edhe **amerikane**

“RRËFIME NË HIJE”, TREGIME NGA RAMIZ GJINI

# Bibolli, kjo vendinë imagjinare ku vegjeton një botë rrëfimore

Sapo keni botuar vëllimin e katërt me tregime të titulluar “Rrëfime në hije”. Ndërkohë, para këtij, botuat romanin “Rreketë”, që i përket si gjini prozës së gjatë. Mos ndoshta, e ndjeni veten më rehat kur merreni me tregimin e shkurtër?

**R. Gjini:** Puna me romanin, ishte më tepër një provë, e cila, ndonëse më lodhi shumë, më solli një satisfaksion të pa provuar më parë. Para se të filloja ta shkruaja, isha i bindur se nuk do ta kisha të lehtë. Në imagjinatën time, sillëshin e përcillëshin imazhet e një jete karnavaleske, ku personazhet, qenë bujtës të sistemit të përcudnuar të para nëntëdhjetës. Tek “Rreketë”, personazhet ngjajnë me njëri-tjetrin. Ata janë, karnavalë, që ecin në një rrugë, që nuk të çon askund, gjykojnë dhe ëndërojnë në një mënyrë masive dhe punojnë për të ndezur një revolucion, që, medemek, do të sjellë ndryshime. Ata nuk janë të qartë se çfarë ndryshimesh duan të sjellin. Demokracia për ta, është një ëndërr e përbashkët, masive, pa qëllime të qarta. Kjo demokraci, është një keqkuptim, ashtu siç ishte edhe socializmi. Kjo i bën ata, që të ndjekin nga pas prijësin, ose prijësit e turmave, që fatkeqësisht, i kemi edhe sot me shumicë. Mirëpo, prijësit e turmave, nuk kanë ide të qarta dhe të realizueshme, siç kanë, ta zëmë, arkitektët. Ato janë udhërrëfues fjalamanë dhe gënjeshtarë. As vetë nuk dinë ku shkojnë. Këtyre lloj prijësish, nuk u duhet rënë nga pas në mënyrë të verbër, ndryshe shoqëria shqiptare do të bjerë në katastrofa të njëpasnjëshme.

Romani, u prit dhe u vlerësua nga ata që e lexuan.

**Ç’mund të thoni për tregimin si gjini, si dhe për librin “Rrëfime në hije”, që sapo botuat?**

**R. Gjini:** Më pëlqen të merrem me tregimin si gjini. Ne këtë dua të them, që më pëlqen të punoj dhe ta vras shumë mendjen për të. Sepse një shkrimtar i vërtetë, bëhet vetëm kur ka talent, kur lexon shumë dhe natën e bën ditë me punë të palodhur. Tregimi kërkon shumë talent. Është gjinia më e vështirë. Atë nuk mund ta shkruash me kulturë të përgjithshme. Kamera e vëzhgimit duhet të jetë e një cilësie shumë të lartë. Një sy i zakonshëm, kot rreket së kërkuari. Sepse nuk është e lehtë, të zgjosh sensacion, të ngjallësh ndjesi e të sjellësh befasime ndjesionuese vetëm në pak reshta. Gjithçka ndodh në jetë, nuk është art, por është prozë e rëndomtë, pa tharm. Nuk mund t’i dalësh zot penës, siç i del, ta zëmë, makinës, apo punës organizative në një institucion. Ai që e kupton ndryshe këtë, gënjën veten. “Rrëfime në hije”, që sapo u botua, ka një lëndë brenda së cilës, gjenden jo vetëm eksperiencia nga jeta shqiptare, por aty ka disa tregime, që sjellin një eksperiencë nga jeta amerikane, të cilën unë, aktualisht, po e jetoj çdo ditë.



**Subjekti i romanit zhvillohet në Biboll, një element që e keni futur edhe në disa nga tregimet tuaja?**

**Cdo të thotë kjo?**

**R. Gjini:** Kam vite që punoj për të ndërtuar një univers timin, një



Prijësit e turmave, nuk kanë ide të qarta dhe të realizueshme, siç kanë, ta zëmë, arkitektët. Ato janë udhërrëfues fjalamanë dhe gënjeshtarë. As vetë nuk dinë ku shkojnë.

Ramiz Gjini. Rrëfime në hije. Tregime  
ISBN 978-99956-04-14-1  
Botimet “m&b”  
Çmimi 500 lekë

hapësirë gjeografike ku jeton dhe vepron një lëndë njerëzore, personazhe, të cilët, i njoh sepse jetoj natë e ditë me ta. Ata ekzistojnë, kanë pasaportë identiteti dhe jetojnë brenda meje. Ata hynë e dalin në tregimet e mia sa herë i thërras.

Bibolli është vendina imagjinare ku vegjeton bota ime rrëfimore. Aty peshkohen temat dhe bëhen realitet idetë. Sepse një shkrimtar, nuk mund të ulet të shkruajë, kur nuk ka një ide. Subjektet e mia, janë pjellë e fantazisë. Unë i ndërtoj ato, ashtu si dua unë duke i bërë të besueshme me artin e fjalës. Unë nuk i dua heronjtë realë dhe i urrej ato proza, në hyrje të të cilave, autorët shkruajnë: “Kjo ngjarje është e vërtetë”. Një ngjarje, mund të jetë e vërtetë, por ajo nuk vlen kur aty nuk ka art të vërtetë. Kjo nuk duhet keqkuptuar.

Po të ishte kështu, frekuentuesit e palodhur të kafeneve, ashikët e muhabetit, do të ishin shkrimtarët më të mëdhenj.

**Ç’mendim keni për nivelin e botimeve sot?**

**R. Gjini:** Sot shkruhen e botohen shumë libra, ndërkohë, që institucioni i kritikës, nuk ekziston fare. Por do të vijë një ditë, që gjithë kjo lëndë bruto, do të siet. Do të siet siç e sisnin rërën kërkuesit e arit në brigjet e lumenjve të Kalifornisë. Uji do të rrjedhë, balta, rëra, gurët, lëvizhet dhe plehu do të hidhen tej. Atëherë, do të shohim çfarë do të mbetet. Të gjithë këpucarët, biznesmenët përlinjë, rritësit e pulave dhe derrave, drejtuesit e partisë dhe shefat, do ta qajnë kohën e “artë” kur duartrokiteshin pse shkruanin edhe libra.

**Bisedoi: BUJAR KAROSHI**

Ramiz Gjini

## Frika

**K**ur barbarët e huaj u dhanë në portën e madhe të oborrit të Lef Kukës, ky i fundit, doli nga dera e pasme dhe arriti të futej e të fshihej në qilar.

Qilari, qe ndërtuar ngjit me ahurin e bagëtive dhe hyrjen e kishte disi sekret. Kur hapej dera e ahurit, fleta e derës, bllokonte atë të qilarit.

Për të hyrë në qilar, duhej të hyje pikësëpari në ahur, pastaj të mbyllje derën. Por, edhe atëherë, për njerëz që nuk e dinin, qe vështirë ta gjenin hyrjen, pasi brenda ishte gjithmonë errësirë e plotë. Për ta mbrojtur ahurin nga hajdutët, dy dritaret qenë zënë me plitharë, dhe, nëse dera ishte e mbyllur, asnjë rreze drite nuk depërtonte aty brenda.

Lef Kuka, u struk i fshehur në qoshen më të errët, prapa një vozi vere. Sipër vozit, gjendej lëkura e tharë e një lepuri të madh, të cilin ai e pati vlarë vite të shkuara. Aso kohe, - kishte qenë e premtë si sot, - Lefi, qe kthyer nga kodrinat me gjahun mbi sup, e kishte ulur në tokë mu në sheshin e katundit dhe ua kishte treguar të gjithëve sa u ndodhën aty, duke demonstruar një krenari prej gjuetari me zotësi të madhe. Dhe kishte hak: askush në katund, nuk pati mundur të vriste një lepur aq të madh sa ai që vrau Lefi.

Tashmë, i fshehur prapa vozit, ia ndjeu asaj lëkure erën e gjakut të tharë dhe i erdhin për të vjellë. Kurse nga jashtë, atij i kapi veshi britmat e çjerra të Danjushës, nuses së vëllait, para së cilës, barbarët shkonin në thikë të shoqin e saj, Gjergjën, - vëllain e vogël të Lefit.

- Jam në vatanin tim..., - u thoshte Gjergja të huajve, - Në shëpinë time....

Në vend që të dilte, Lefi u rras edhe më tepër në skutën e errët dhe ra në një gabim fatal, për të cilin, jo në këtë jetë, por në atë tjetrën, do të pendohej rëndë: iu lut Zotit, që të mos hapej dera e qilarit.

Pastaj, zëri i të vëllait erdh’ e u shua derisa shpirti i tij u ngrit në qiell.

Atë çast, dikush e pështyu në kokë Lefin.

Kur ktheu sytë lart të shikonte kush qëndronte mbi trarët e tavanit, një tjetër pështymë i ra në fytyrë.

Jashtë binte shi dhe çatia pikonte.

Baptima e hapave të një njeriu, që afrohej drejt ahurit, teksa tërhiqte zhakthi një tjetër, e bëri Lefin, t’i rrihte më fort zemra. Pastaj, kur dera e ahurit u hap duke bllokuar atë të qilarit, ai ndjeu dihatjen e rëndë të një mashkulli, kërcënimit e tij në gjuhë të huaj si dhe të qarën e mbytur të Danjushës, teksa i lutej tjetrit, që për hatër të zotit, ta falte.

Vetëm një metër larg, matanë murit që i ndante, i huaj, shfryu gjer në fund epshin e tij mbi nusen e të vëllait.

Lef Kukës, erdh’ e iu rëndua aq fort zemra, sa iu bë si gur i thyer varri. Kurse frika, gjithnjë e më tepër, si një merimangë e madhe skutash të errëta, vazhdonte ta mbështillte me fije të holla e të forta, derisa ai, e pa vehten të mbyllur si krimbi brenda pezhishkës.

Pastaj, barbarët i nxorren nga ahuri të gjitha bagëtite: kalin, dy qetë, lopën si dhe tufën e deleve.

Pak nga pak, zërat e tyre urdhërues dhe klithmat e banorëve të pafajshëm erdhën duke u fashitur. Atëherë Lefit, iu ndez një shpresë, që Zoti, vërtet ia kishte dëgjuar lutjen dhe dera e qilarit nuk do të hapej.

Kur nata iku bashkë me tmerret, ia behu mëngjezi; i paqtë e me një diell të shndritshëm, që i bëri gjallesat të zhurmonin hareshëm. Jeta gëloi natyrshëm si rrjedha e një uji të ëmbël, që del nga nëntoka për t’iu kthyer edhe njëherë bimësisë nga rrënja në gjethe.

Lef Kuka, provoi të lëvizte, por kurrësesi nuk mundi. Nuk kishte as këmbë, as dorë, madje as edhe një muskul në trup, që të mund ta vinte në lëvizje.

Sa shumë deshë atë botë Lef Kuka, që të vinin ta gjenin.

Kushedi sa herë, ai dëgjoi hapa dhe zëra njerëzish që i njihte. Madje në një rast, ata hynë edhe në ahur për të parë mos kishte mbetur aty ndonjë kokë bagëti, por as që e morën mundimin për të hapur derën që të fuste në qilar.

Brenda pezhishkës, i dërmuar shpirtërisht, atij iu pak aq shumë fryma, sa nuk mundi të nxirrte as edhe një tingull nga goja.


Dhe, kur koha rrodhi e zërat erdhën duke u dëgjuar gjithnjë rrallë e më rrallë, vetëm atëherë, ai u kujtua që i ishte lutur Zotit të mos hapej ajo derë.

Dhe mbylli sytë që të vdiste.

Ajo që nuk është e sigurtë është se nuk e di në se ndonjëherë, të paktën nga kodrat e Cerenit do ta shoh atë bukuri që ka hyrë e më ka ngelur në shpirt nga malet e Kalasë së Dodës dhe nga njerëzit e saj punëtorë...

emigracion

# Nuk kam gjunjë për Korab, Sali Hafuzi!



Mbi Sorokol

Nga: **ABDURAHIM ASHIKU**

E pata takuar një ditë tek "Iliria" në Omonia. Donte ta kishte Shqipërinë me vete ndaj interesohej për një antenë satelitore. Sa u njohëm, sa shkëmbyem pak fjalë, sa më ngjiti në Ceren dhe... më la. E dinte se kisha ku ta kaloj natën, madje edhe ditët dhe netët. Kishin mjaftuar disa emra njerëzish të njohur, njerëz me rrënjë e me degë si ato të Ziaudin Vishës, vëllezërve e bijve të tyre që të ndjente siguri se nuk do të humbja. Mori me vete kartën me telefonat e mi dhe nxitoi që të mos humbte punën...

...Të shtunën më mori në telefon. Më kishte marrë edhe dy herë të tjera por këtij drejt telefoni seç i kisha shtyp dhe bubërronte si bubuzhel në vetvete, dridhje e përdridhje por zë nuk lëshonte...

...Kur u lidhëm më tha emrin, më pyeti edhe në se e kujtoja. E si të mos e kujtoja njeriun që më kishte trazuar vendit e më kishte ngjitur mbi Korab? Më tha se ishte në Omonia dhe donte të më takonte. Ishte vonë dhe që të shkoja deri atje duhej humbur e gjithë mbrëmja ndaj, kur më tha se banonte në Marusia i thashë të merre autobusin A – 8 dhe të takoheshim tek Sheshi Amerika.

Nuk u vonua. E pashë kur zbriti nga autobusi dhe i thirra para se ai të më shikonte. I qeshën sytë, qeshje karakteristike që mund ta gjeje vetëm ndër lumjanët në rrënjë të Korabit...

U ulëm, unë duke gjerë kafën kurse ai duke rruftur portokalladën. Harrova të shkruaj se kur më telefonoi, para se të caktonim vendtakimin, më pyeti për këngën e Rexhës, atë këngë që fillon "Çou Rexh e hipi kalit, çou Rexho, çou djalo", atë këngë që në zërin e Lirie Rashës dhe nën melodinë e kavallit të Myfterim Kupës kthehet në perlë. Kishte bërë një debat me një shok se nga është dhe kush është Rexha i vërtetë i këngës por nuk kishin ra në ujdi. Më vuri në mëdyshje dhe po në mëdyshje iu përgjigja: "Nga Dibra apo nga Kosova?"...

... Me kaladodasit asnjëherë mos hyn në debat gjeografik...

Të vjetrit e njihnin Ballkanin me pëllëmbë. Dimrit ata merrnin djemtë, delet dhe kuajt përpara, zbrisnin malet - bedena të Korabit, takonin stacionin e trenit në Shkup dhe shkarkoheshin në fushat e Thesalisë. Thonë se në luftërat ballkanike ata kanë humbur në shtegtimin e tyre mbi shtatëdhjetë e pesë mijë krejtë dele...

Verës ktheheshin në bjeshkët e Korabit, bjeshkët më të bukura e më të begata, me ujë që të çan ballin dhe me kullota që nuk i çan kali. Haki Stërmilli, shkrimtar dhe studiues di-bran, thotë në një dorëshkrim se "Në kohën e Turkes këtu verorin një milionë dele". Hakiu e kishte fjalën për tërë masivin kullor të Korabit, masiv i cili në vitin 1913 u nda nga Londra për t'ia dhënë pjesën më të madhe Serbisë.

...Me kaladodasit asnjëherë mos hyn në debat gjeografik...

Të rinjtë, ata që para vitit 1990, ishin në moshë pune, i njihnin fshatrat e Shqipërisë më mirë se vendasit. Puna gjatë dimrit në grumbullimin e shqopës, në ndërtimin e lerave për grumbullimin e ujit në kullotat e larta, ngritja e shtyllave elektrike centrifugale...kishte bërë që ata të mos linin fshat, kodër e mal, kryesisht të Shqipërisë së Mesme dhe të Jugut, pa shkelur me këmbë dhe prekur me dorë. Punën e kishin qejf ta merrnin "me akord". Kështu ua jepnin kryetarët e kooperativave se kush drejtin mund t'i ndiqte ata ditë për ditë majë maleve tek shembnin shkëmbinjtë e ngrin lerat e ujit. Njerëz ma punëtorë nuk i bën nëna. Shtegtimi i lirë apo vjedhurazi me delet në dimër kishte bërë që ata të mos linin fushë, kodër e luginë pa e provuar e shijen e

qumështit nga bari i kullotave të begata. Mos hyni në debat me ta sepse do të përballeni me atë shprehjen e njohur popullore "Eja babë të të tregoj arat". Kështu u ndodha edhe unë kur ra muhabeti për ultësirën e Fierit, Shëndëllinë, Hoxharën, Semanin...Ai i njihte kaq mirë sa unë që kisha kaluar vetëm një herë në rininë time e ndjeva veten ngushtë.

Ngushtë e ndjeva veten edhe kur morëm të përpjetën për në Sorokol, Fushë të Korabit e perlën e malit të lartë "Fushën e Ponairit", atje ku kam qenë në vitin 1988 e ku Gani Xhengoja i fotografisë shqiptare më bëri atë foto që e kam vënë në koperinën e librit "Njerëz që i dua", atje ku thonë se shumë e shumë vite para Pavarësisë bëheshin panairë blegtorale e gara sportive ballkanike, hipizëm, garë qethje delesh...Por më e forta, që jeton edhe sot, sidomos në ditë të Shëngjergjit në pranverë, por edhe në vjeshtë, ishte gara e "Vagës". Se çfarë është "vaga" do ta mësoja kur më treguan një stampë metalike mbi peshore ku shkruhej "weight". Fjala angleze ishte shqiptuar "vagë" dhe kishte hyrë në fjalorin e zonës si proces peshimi dhe gare se kush e kishte qengjin apo dashin me peshë më të madhe...

Saliu e ka shtëpinë në atë rrafshën e vogël që formohet si një shkallë para se të ngjitesh e t'i qëndrosh Cerenit në qafë. Atje ka prindërit, ka edhe katër fëmijë, tre djem e një vajzë. I ri është Saliu në moshë por i vjetër në traditën e martesës së hershme që, siç thuhet në popull, fëmijët t'i bëhen krah shpejt. Nuk i ka shkullur themelet, ndonëse në Bërxull të Tiranës e ka një copë tokë, për të mbajtur ndonjë bagëti e për të ngritur ndonjë shtëpi. Në Ceren ka një "dorë" dele, ka edhe "katër lopë" e "tre kuaj". I ka të gjitha ato që në psikologjinë e zonës e bëjnë njeriun të qenur. E dini se cili është boshti i jetës në malet e Kalasë së Dodës? Është një trinom me "Zotin në qiell dhe Djalën, Delen e Kalin në tokë". E pyes Saliun për blegtorinë, për drejtimit që ka marrë ajo në vitet e tranzicionit. Më thotë se kur ishin të vegjël i detyronin prindërit tu dilnin lopëve përpara kur ktheheshin nga kullota që të mos u hynte viçi nën gji dhe u merrte qumështin. Tashti, tha ai, i lëmë viçat të pinë sa të duan qumësht sepse qumështin e lopës nuk e marrin baxhierët e ardhur nga Kavaja. Marrin vetëm qumështin e deles edhe atë me 80 lekë litrin. Të lopës, edhe kur e marrin, nuk japin më shumë se 40 lekë për litër, ndaj më me leverdi është ta pijë viçi e të vejë mish. Megjith-

atë, shton, ne ia kemi gjetur, e përziejme me qumështin e deles...

Saliu nuk të lë në një vend, të merr e të ngjit bjeshkëve, edhe pse e din se ti nuk ke gjunjë dhe të përpjetat atje maten me gjatësinë e trupit. Edhe mua ma ka ënda të ngjitem. A mund të rrih në vend kur ngjitesh në rrafshën e Cerenit dhe para teje, në tërë harkun e rrethit të shikimit pamjet janë njëra më e mahnitshme se tjetra. A mund të rrih pa u ulur në gjunjë në barin e njomë të majit kur përballë teje Korabi e ka hedhur qelshen e bardhë në sy e të fton, jo të ecësh por të vraposh drejt tij? A mund të rrih pa u dehur nga bukuria e gipseve që zbresin deri poshtë e lahen në ujin e Veleshicës dhe ngjiten deri lart e krihen në pishnjat e Livadhit të Gjatë? Po kur kthehesh paksa prapa dhe vështrimi yt ndalet mbi Qoshtë, Shulla e Vasie, pyllin e vogël me mëshkëna në kodrën e Kiavetit ku më 22 shtator të vitit 1944 derdhi gjakun heroit shqiptar nga Kosova Hajdar Dushi, kur pak më lart sheh rrënojat e kalasë së moçme nga ka marrë emrin edhe zona, nuk ke se si, me çfarë dallge burimi ta shuash dëshirën për të vrapuar e ndaluar në ato vende ku bukuria dhe begatia shkrihen në një me mikpritjen...

Këtu, në këtë vend në këtë shesh të Cerenit ku janë edhe zyrat e komunës, duhet të ndalesh pak, ta ngrish vështrimin, ta ngrish edhe trupin. Të detyron një zakon i vjetër, zakoni që në vitin 2013 mbush shekullin. Në Ceren ka një varrezë që nuk e gjen në asnjë vend të Shqipërisë, "Varreza e Shahitëve" siç e quajnë në gjuhën vendase. Atje janë varrosur, në vjeshtë të vitit 1913 djemtë dhe burrat e Kalasë së Dodës të masakruar nga serbët. Janë 35 varre, 35 burra emrat e të cilëve do t'i gjeje edhe në analet e diplomacisë evropiane të kohës. Unë i kam lexuar ato në gazetën "Përlindja e Shqipërisë" të fillim vitit 1914, gazetë e Qeverisë së Vlorës. Njerëzit e Kalasë së Dodës prej kohës i qëndrojnë besnik një vendimi. Kush kalon para varrezës duhet t'i zbrësë kalit dhe me vështrimin majtas ose djathtas të ecë në tërë gjatësinë e rrugës në heshtje. Edhe dasmorët, kur kalojnë andej, me flamurin kuq e zi në ballë, normë e hershme në dasma, u zbrësin kuajve, ndalojnë daullet e curlet, nderojnë dëshmorët...

...Saliu nuk donë të shkëputet nga vendlindja, vendi ku thotë se shkon e rri dy muaj në vit. Marrim paksa teposhtën e Cerenit, ndalemi pak tek kulla e Ziaudin Vishës, në atë bahçe që njeriu i punës dhe i mendjes pat

krijuar duke ia marrë tokën malit, hedhim sytë poshtë në Çernjevë, fshatin e parë të të pesë fshatrave të Radomirës; Çernjeva, Dërbaçi, Kullasi, Tejsi dhe Stredoku për ta ndalë shikimin në pyllin me pisha të Radomirës. Është një ndër pyjet që është krijuar dhe mirëmbahet me një fanatizim të fortë nga vendasit, pyll që i qëndron Dërbaçit e Tejsit si mburojë e sigurve nga ortekët që vijnë nga lartësitet e Sorokolit për tu thyer e bërë copa në trungjet e pishave.

Saliu e ka një merak, donë të ndalemi pak në Sdredok ku fëmijët e tij janë nipër dhe e shoqja është bijë. Mua nuk më del koha...

Dua të ngjitem deri në bjeshkët e Preshit, të fus duart në ndonjë rrëke që del nga e çara e veprës së marrjes së ujësllësit që shkon deri në Peshkopi, të mbush gojën me atë ujë që nuk e ka kush. E kam provuar atë ujë kur dilte nga gurra, poshtë një shkëmbi të madh, në virgjërinë e natyrës...

Dua të ngjitem edhe tek shpellat, tek burimi tjetër i madh i ujit, burimi që siç thonë nxori bojë kur ndaheshin kufijtë, kur fushën e Ponairit donin t'ia jepnin serbit. Një qeskë me bojë atje ku ujërat e fushës humbin në shkëmb mjaftoi për tu treguar "komisioneve" se ai ujë, ajo fushë dhe ato vendurime janë pjesë e një trupi, nuk mund të ndahen.

Ënda ma ka të marr edhe të përpjetën e rrugës së moçme të karvanëve për të pushuar pak në Fushë të Korabit për të dëgjuar këngët e moçme të kurbetit, atë këngën "Oj fusha e Korabit, oh e mjera unë"... Për ta ndalë syrin në ata shkëmbinjtë - bedena që vendasit i quajnë "Luftinë" e ku kanë luftuar rreptë e kanë rënë kundër serbit motër e vëlla...

Nga Sorokoli që sheh bjeshkët e plota të Korabit, të kësaj e asaj ane të kufirit, qejfi ma ka t'i hedh një sy "Kthesës së Koke", kthesë që lakon kufirin duke depërtuar thellë në krahun tjetër. Ka një histori ajo kthesë, histori të lidhur me pushkën e fisit Koke që nuk i lejoi komisionarët të marrin tokën e tyre, bjeshkën e tyre. "Kthesa e Koke" i thonë dhe do t'i thonë me siguri edhe kur të shkrihen kufijtë e të jemi të gjithë në Evropë. Historia kur shkruhet me pushkë nuk shuhet dhe harrohet...

...Po ndalem. Nuk udhëtoj dot më shumë as edhe me mend. Të lodh ajo bukuri. Të lodh në trup por të çlodh në shpirt. Po ndalem sepse Saliu ma preu rrugën e maleve dhe më zbriti në asfaltin e Athinës.

Saliu i bie kavallit. Tashti, kur po ndaheshim i mora vesh pse ai më pyeti për këngën e Rexhës. E kishte në melodinë e kavallit të tij që e kishte bërë me porosi tek një mjeshtër në Janinë në udhëtimet e tij pa mbarim maleve derisa bëri letrat...

I dhashë telefonin e Kastriot Lekdushit. E di se pas çiftelisë që më në fund e gjeti, kavalli plotëson atë që ai ka ndërmend të krijojë, ansamblin "Na bashkoi isoja labe dhe çiftelia". Ndonjë ditë besoj se do ta dëgjojmë melodinë e dalë nga shpirti i Sali Hafuzit dhe hapësira e kavallit të tij.

Me siguri do ta dëgjojmë.

Ajo që nuk është e sigurtë është se nuk e di në se ndonjëherë, të paktën nga kodrat e Cerenit do ta shoh atë bukuri që ka hyrë e më ka ngelur në shpirt nga malet e Kalasë së Dodës dhe nga njerëzit e saj punëtorë...

Athinë, 11 maj 2008

e-mail: [a\\_ashiku@yahoo.org](mailto:a_ashiku@yahoo.org)

## LAJMËRIM

Në kujtim të 32 dibranëve të zhdukur në ujërat e Otrantos në natën e 9 marsit 1996, po përgatitet një libër. Ftojme të gjithë familjarët, të afërmit dhe të tjerë që kanë dijeni për këtë ngjarje të përcjellin në adresën e gazetës "Rrugë e Arbërit", fotografi, shënime për jetën e personave, dokumente, kujtime, etj. Le të jetë ky libër një lapidar për ta.

Adresa: "Botimet "m&b", Rr. "Zenel Baboçi", Pall. "Ferar", Tiranë. (Për gazetën "Rrugë e Arbërit").

E-mail: [rrugearberit@gmail.com](mailto:rrugearberit@gmail.com)

# Shkolla pedagogjike e Peshkopisë, një fidanishte mësuesish

Nga: Dr. HASAN LEKA

Në shtator u paraqita në shkollën pedagogjike për t'u rregjistruar. Atje isha njohur qysh në 7 vjeçare pasi ne erdhëm në konviktin e Peshkopisë pasi u mbyll ai i Shupenzës.

Kështu unë kisha vetëm hallin e mësimeve se me shumë veta njihesha më parë. Në shkollën pedagogjike kishte konviktorë nga Dibra, Kuksi, Mati, kurse atë vit erdhën edhe nga Tropoja e Kruma. Kishte dy vjet që shkolla kishte nga dy paralele. Nxënësit e maturës së vitit të tretë jo vetëm ishin më të rritur, por edhe të veshur me bukur e fodull në paraqitje. Maturantë ishin në atë kohë Xhelil Gjoni, S Shehu, H. Shehu, E. Braha, A. Tota, G. Kurti e shumë të tjerë që s'i kujtoj tani. Shkolla kishte mësues të talentuar si shkollanët Sh. Hafizi, H. Kaduku, P. Dizdari, S. Temo nga Korça, J. Levani e A. Lakuriqi nga Elbasani. Drejtor shkollë ishte Astrit Hoxha dibrani i mirë dhe respektuar, një burrë i shkurtër, profesor matematike. Ai ishte energjik e shumë autoritar. Para tij dridheshin pedagogët jo më ne nxënësit. Kur kalonte nëpër koridore të gjithë futeshin nëpër klasa, sepse po të shikonte ndonjë çrregullim, qoftë edhe në veshje e qethje, të merrte erzin. Por kjo i shkonte shumë se ishte tepër serioz dhe nuk kërkonte gjëra kot. Ai ishte dhe një futbollist pasionant. Shkolla kishte laborator kimie e fizike, sallën e muzikës të kompletuar me violina, ku jepte mësim pedagogu e kompozitori Munir Shehu.

Shkolla organizonte konkurse matematike, letërsie, për vizatimin e shkencat e natyrës. Për vit të ri ndaheshin çmimet e fituesve ku konkurenca ishte shumë e madhe, ndonjë shpërblimi ishte një fletë nderi, ndonjë bllok e stilograf. Brenda shkollës kishte dhe një shkollë ushtrimore ku bënim praktikë pedagogjike për dhënjën e mësimin. Atje jepnin mësim mësueset e talentuara Jolanda Radi, Irena Bitri, Hava Shehu, Rremzi Prapaniku që plot pasion e mjeshtëri na edukuan e na mësuat metodat dhe artin e të dhënit mësim e të organizimit të klasës në kushtet e moshave të ulëta. Na kultivuan dashurinë e respektin për fëmijët gjë që më ka shërbyer shumë kur u bëra mësues, por edhe më vonë në detyra të tjera. Ne nxënësit e vitit të parë dëgjim me respekt për ish nxënësit e kësaj shkollë që pas mbarimit të maturës studionin në Universitetin e Tiranës ose në Moskë e vende të tjera si: N. Abdiu, Z. Sula, V. Bici, L. Koldashi, M. Cani, A. Sollaku, Xh. Gjoni, E. Hysa, H. Shehu, A. Baleta, S. Tomçini e shumë të tjerë që shkëlqyen në karrierë duke u bërë të njohur në tërë vendin në fusha të ndryshme të dijes e kulturës, në diplomaci etj. Disa prej tyre si Z. Sula, M. Cani, I. Erebara, S. Vraniçi, Sh. Manjani u kthyen pedagogë në shkollën pedagogjike duke zëvendësuar pedagogët e rretheve të tjera. Ata vazhduan dhe konsoliduan një traditë të mrekullueshme që kultivuan pedagogët nga Shkodra dhe Elbasani duke e bërë shkollën pedagogjike të Peshkopisë një fidanishte të shkëlqyer të mësuesve për zonën verilindore. Mësues të talentuar të dalë nga kjo shkollë kanë punuar plot pasion që nga Mati, Kruja, Kukësi deri në Tropojën e largët, duke përgaditur breza të tërë nxënësish me njohuri shkencore, edukatë e kulturë të shëndoshë për jetën. Nxënësit e pedagogjikës kanë konkuruar me sukses në Universitetin e Tiranës dhe jashtë shtetit. Unë jam krenar që kam qenë nxënës i kësaj shkollë dhe ruaj kujtimet më të mira për të. Dhe mblidhemi plot nostalgji e krenari çdo përvjetor mature me shokët tanë. Vitet e shkollës së mesme pedagogjike kanë qenë dhe mbeten për mua më të bukurat e jetës shkollë. Që vitin e parë, veç programit



Matura e viteve '60

mësimor që ishte shumë i ngjeshur ne kishim edhe një program relativisht të pasur aktivitetesh kulturore, sportive e shkencore. Bënim një orë studim në mëngjez dhe tre orë studim pas dite. Kur ishte dita e gjatë loznim futboll, volejboll, shah e pinpong ose bënim ndonjë xhiro të shkurtër në bulevardin e bukur të Peshkopisë. Dy herë në muaj na çonin në kinema ose në koncertet që jepte pallati i kulturës. Kur ishte dimër ose dita e shkurtër mbylleshim nëpër klasa duke treguar barçoleta ose duke lexuar libra artistik. Në raste të veçanta shkonim për ski në livadhet e Staravcit që kishin një bukurie të veçantë në dimër, ose në zbritjet e Kubenit e të Dobrovës. Na pëlqenin filmat me luftë, por tentonim të shihnim edhe filma të ndaluar të kohës si "Vagabondi" "Zotnia 420" etj. Futeshim nga dritaret prapa kinemasë, dhe e shikonim filmin nga prapa, pa i lexuar shkrnjat. Në këto veprime kishim hëngër edhe ndonjë tërheqje veshi nga Shahini i gjatë, përgjegjësi i kinemasë, që herë pas here dilte e kontrollonte prapa skenës, ku ne fshiheshim në kartona e perde si minjtë. Shumë të bukura ishin piknikët që bënim në livadhet er Dohoshishtit ose buzë Drinit. Mërmim me vehte ushqimet që na pregadiste konvikti, veglat muzikore dhe me këngë rinore shkonim nëpër livadhe. Bënim lojra si me top, gara vrapimesh e kërcimesh dhe pastaj grupe grupe ndaheshim nëpër lëndina. Herë pas here bënim krosete masive, spartakiada me disa lloj sportesh, konkurim me Teknikumin Bujqësor por edhe me ekipet e spitalit e të ndërmarjeve të Peshkopisë. Pedagogu B. Shehu dhe D. Doçi ishin të pasionuar e tepër kërkues për këto aktivitete. Në nëntor bënim festën e shkollës që ishte diçka madhështore. Aty kishte këngë e valle korale në grupe dhe të veçanta. Pas konkursit midis klasave, pjesët më të bukura harmonizoheshin dhe jepeshin në koncertin përfundimtar në kinemanë e qytetit. Grupi i violinave, i mandolinave, i valleve popullore ishin të mrekullueshme. Pedagogu M. Shehu nxorri talente në muzikë si A. Balliu, N. Mazari, M. Iskurti. Këngëtarë si M. Shehu e valltaren e talentuar K. Buci që arriti të kërcejë pjesë nga baleti klasik rus. Ajo vajzë që si një lule që çel para kohe dhe pati një fund tragjik. Nga viti 1956 e prapa në Pedagogjike erdhën edhe konviktoresh femra që i dhanë më shumë gjallëri jetës. Gati çdo dy javë në menxën e konviktit bëheshin mbremje letrare artistike e vallëzimi. Janë të kësaj kohe këngët "Cuca matjane", Katundarja në katund të ri", ose vallja e kënduar "Oj Sanie motër o, hiqe vallen rrotull o" Ishin veç të tjerave tre Sanie konviktoresh që kërcenin: S. Zeneli, S. Berisha, S. Gjikola. Ato qenë vajzat e para

që thyen fanatizmin e egër dhe kapërcyen me guxim prapambetjen e femrës dibrane duke ndjekur shembullin e Vera Muçës, Adivije Lazrit e të tjera femra trimëresha e të respektuara në Dibër që ishin pionieret e para të emancipimit. Ne ishim të etur për dije e kulturë. Lexonim çfarë të gjenim e na vinte në dorë. Gjenim mundësi dhe merrnim libra të verdhë nga një këpucarë që na i jepte fshehurazi. Zeqiu një burrë i gjatë me kasketë na rregullonte këpucët, më shumë pa para se me para, se e dinte që ne ishim konviktorë dhe i vinte gjynah. Ishte i apasionuar pas librave. Nga ai merrnim libra të verdhë të ndaluar si "Zonja kamelië", "Ura e psherëtimave", "Bija e mallkuar". Të këndëshme ishin për ne orët e letërsisë dhe historisë. Pedagog kishim Sh. Hafizi i cili ishte njeri i mrekullueshëm në sjellje e shpjegime. Ekzmlar i veçantë ishte profesor Jorgji i historisë, një burrë plak, fisnik, ish sportist e tifoz i çmendur i Korabit. Orën e historisë na e bënte kaq të këndëshme sa e prisnim me dëshirë e ikte ora e mësimin pa u ndjerë fare. Krejt ndryshe ishte profesor Ismaili. Ai ishte shumë korrekt e kërkues por dhe nevrrik. Lëvizte gjithë nervorizëm kur ndonjë nxënës i dobët nuk i zgjidhte ushtrimet e problemat e sterometrisë ose të algjebërës. Ishte mjaft i ndershëm dhe pasionant në punë. Kur dilte në dërrasë të zezë Zefi nga Tropoja profesori kënaqej e fillonte të fishkëllente lehtë. Mësues Z. Sula erdhë pas studimeve nga Moskë dhe filloi të na jepte ne rusisht. Ishte një talent i vërtetë, një erudit e pasionant në letërsi. Vitin e dytë u bë drejtor dhe kështu ne nuk na jepte mësim. Ai kishte aftësi dhe talent që nuk e shkriu në drejtimin e duhur. Do të ishte bërë padyshim një shkrimtar i madh apo një kritik arti. Mësues të tjerë si Juli Levani, Shemsi Manjani, Sabri Vraniçi, Nevrez manjani, R. Manjani etj, ishin pedagog pasionantë e sistematik që na i bënin orët e mësimin me nivel shkencor e metodik e ngulmonin në përvetësimin e tyre. Shemsiu ishte dhe një sportist i zoti. Një mësues i talentuar ishte Andon Lakuriqi. Ai na jepte vizatim e punë dore. Ishte njeri estetik e vishej me shije. Që atëherë ne njohëm albumin me piktura e skulptura të Luvrit, të Mikelanxhelos etj. Ai na mësoi të vizatonim bukur, të njihim e vlerësonim artet e bukura, të dinim të punonim me letër. E sot ajo plejadë e madhe në të gjithë zonën verilindore të vendit mburren me të drejtë, mburren që kanë mbaruar shkollën pedagogjike të Peshkopisë, këtë fidanishte që nxorri mësuesit e parë të kësaj zone mjaft të madhe. Nga kjo shkollë të gjithë ish nxënësit e saj fituan një përvojë mjaft të pasur në fushën e mësimdhënjes.

## REQUEM PËR NJË MËSUES

### Bexhet Cibaku, mësuesi i parë i Sohodollit

Bexhet Cibaku u lind në Sohodoll të Dibrës më 28 shkurt 1930 dhe u nda nga jeta më 30 janar 2008. Për 40 vjet ai shërbeu si mësues duke kontribuar me mish e me shpirt për edukimin e sa e sa brezave. Ai u takon atyre zgalemëve të parë që afruan në sofrën e dijes dhe saqat bëhen përçuesit e saj të bindur e të devotshëm, duke filluar misionin e mësuesit vetëm pak vite mbas luftës nacional çlirimtare (në vitin 1947). Për këtë arsye, mësuesi i popullit, Prof. Dr. Nuri Abdiu, duke vlerësuar kontributin e vyer të Bexhet Cibakut në fushën transmetimit të dijes, thotë: "Ai është arsimtari i parë i dalë nga Sohodolli i Dibrës". Disa vite më vonë Bexheti përfundon studimet në famshmen Normale të Elbasanit. Si normalist, ai dallohej për inteligjencë, përkushtim, seriozitet dhe rezultate të larta. Kjo bazë shkollimi e brumosi atë si kuadër dhe njohuritë e fituara në këtë vit atdhetare do t'i shërbenin atij si një prelude përgjatë gjithë veprimtarisë aktive të zhvillimit të procesit mësimor-edikativ dhe zbatimit të teknikave e metodave didaktive bashkëkohore. Në shoqërinë e stafëve pedagogjike ai gjithnjë punoi me kërkesa të tendosura për ngritjen e cilësisë së përvetimit të dijeve nga ana e nxënësve. E shikoje përkrah arsimtarëve Shemsi Zhulali nga Libohova, Zyhd Bajë nga Shkodra, Xhemal Haraçiu, Ibrahim Xhediku, Esat Huta, Fadil Merdini nga Sohodolli, Elmaz Çira, Sulejman Shini, Xhevat Drizi nga fshatrat e Kastriotit në diskutime profesionale e biseda të lira midis miqsh. Bexheti punoi si mësues në krahinë të ndryshme të Dibrës. Ai shërbeu për edukimin dhe arsimimin e nxënësve në Sohodoll, në disa fshatra të Kastriotit e deri në zonat e largëta si Luznia, Topojani i Shupenzës dhe lartësitë e Zimurit. Kam dëgjuar se plaku i urtë, Driz Zimuri, e mbajti Bexhetin në shtëpi kur seksioni i arsimit e caktoi mësues asaj ane. Në vitet 1968-1972 punoi në zonën e Shupenzës. Ende sot në Shupenzë njerëzit do të shprehin: "kemi patur një mësues nga Sohodolli, Bexhet Cibaku, sa burrë i mirë që ishte". Zylfi Hasan Tafa, ish drejtor i shkollës tetëvjeçare të Sohodollit ka hedhur në një ditar këto shënime: "Me Bexhetin kam punuar në një kolektiv, për më shumë se 30 vjet. Fillimisht në Kastriot dhe kohën më të madhe në Sohodoll. Ai shquhej për thjeshtësi, korrektesë, sinqeritet. Ishte i përkushtuar në maksimum për punën e tij si mësues. Gjithmonë mbeti një figurë e besuar dhe e pastër morale. Këshillohesha me të për shumë çështje, gjithnjë fjala e tij më ka vlejtur shumë. Edhe pse sot nuk jeton, unë i jam mirënjohës për shumë e shumë gjëra". Për kontributin e tij, punën gjithë nerv e përkushtim në trasmetimin e dijeve, për aplikimin e metodave didaktiko-mësimore, për inkurajimin e të mësuarit logjik, Bexhet Cibaku është nderuar disa herë gjersa doli në pension në vitin 1985. Sa e sa breza "thyen" dorën e mësuan ABC-në, u formuan e u rritën nga duart e mësuesit Bexhet Cibaku. Mjek, agronomë, shoferë, ekonomist, oficerë, inxhinier janë sot ish nxënësit e mësues Bexhet Cibakut. Ndaj arsimit dhe këtyre mësuesve të dijes ne kategoria e njerëzve të zakonshëm, kemi borxh një reagim përlules për hir të fisnikërisë që mëkojnë dhe objektit që gdhendin njeriun! Ndoshta, vetëm për këtë arsye Robindrana Tagora nënvizonte se "arsimi është hyjnësia e popullit!". Prandaj mësuesit, mes tyre veçmas Bexhet Cibaku, rrezëllojnë të sigurtë madhësitinë e tyre, përmes ndërtimit të një raporti ndërgjegjësor, ndërmjerëzor, që lartësohet për ditë.

Shuaip Methasani

Një vështrim mbi gjendjen aktuale të pyjeve dhe kullotave dhe disa mendime për mënyrat se cilat mund të jenë mënyrat dhe rrugët e një shfrytëzimi sa më racional

# Reforma në pyje dhe kullota duhet të vazhdojë

Nga: **REXHEP NDREU**,  
Kordinator i Federates së Pyjeve e  
Kullotave Komunale Diber

Këshilli i Ministrave ka marre vendim për transferimin e mbi 700 mijë hektare Pyje e Kullota në pronësi të Komunave dhe akoma menaxhimin e tyre e ben Ministria e Mjedisit.

❖ Mungojne institucionet ligjore për keshillimin dhe monitorimin e pronareve të rinje të Pyjeve

❖ Mungojne strukturat e sherbimit dhe strukturat e menaxhimit për pronat

❖ Mungojne strukturat për kontrollin e zbatimit të ligjshmerise dhe vete ligjet që duhen ndryshuar kur kane ndryshuar pronaret dhe menaxheret

Qeveria Shqiptare mori vendimin për të mbeshtetur pyjet tona bazuar dhe nga një buxhet të dhene prej 19.4 mil USD për një projekt zhvillimi për pyjet komunal për 5 vjet. Ky projekt synon menaxhimin e burimeve Natyrore bazuar në komunitetet në 218 Komuna. Qeveria dhe vecanerisht K/Ministri i Shqiperise arriti të shpejtoj procesin deri në transferimin e Pyjeve dhe kullotave në pronësi të NjQV. Ky është një veprim që duhet pershendetur dhe për kete Federatat e Pyjeve Komunal ka mbi 5 vjet që llojnë në kuadrin e avokatesise për pronaret e Pyjeve tradicional në Shqiperi.

Por a është e mjaftueshme reforma, a duhet vazhduar apo lenë në rrugë e diskretituar?

Për kete Federatat u mblodhen dhe diskutuan në Tirane e Tropoje me misionin e Bankes dhe me Ministrin e Mjedisit dhe paraqiten tek të gjitha nivelet kerkesat e tyre për të ndryshuar me urgjence aktet ligjore dhe n/ligjore, strukturat menaxhuese dhe strukturat e tjera për të gjitha pronat kur kane ndryshuar pronaret.

Propozimet janë të qarta:

1. Të fillojë menjehere permiresimi i ligjit për burimet natyrore (pyje, kullota gjueti, bime medicinale sepse nuk reflekton realisht në realitetet e reformave të bera nga Qeveria në Shqiperi
2. Rregullimi i skemes së punës institucionale dhe ligjore që del nga boshlleqet e dukeshme dhe paqartesia e deri sotme.
3. Riorganizimi i sherbimit Pyjore si rezultat i transferimit tokës në NjQVendore
4. Krijimi i strukturave të sherbimit keshillimor për pyjet e kullotat komunale në nivel Qarku në varësi të drejtorise së politikave pyjore.
5. Organizimi i strukturave me funksione kontrolluese dhe monitoruese tek pyjet komunal e pyjet private për të siguruar vazhdimësinë e funksionimit të planeve dhe menaxhimin e pyjeve dhe kullotave dhe burimeve të tjera të transferuara
6. Krijimin e sherbimeve teknike e keshilluese për Shoqatat Komunal dhe fermeret që merren me menaxhimin e Burimeve Natyrore.
7. Ndarje e sherbimeve të menax-

■ Një strukturë në nivel qendror pa konflikt interesi duhet të jetë për t'u përfshirë për zbatimin e ligjit, duke kontrolluar të gjitha pronat që ka DSHP, KOMUNA dhe Privati.

himit për të gjitha pronat dhe kontrolli i zbatimit të ligjit nga struktura të vecanta të pamvarura.

8. Permiresimi gradual i strategjise së Zhvillimit të Burimeve Natyrore. Në kushtet e krijuara jemi para një situatë kur Ministria duhet të vazhdojë të konsultohet në të gjitha nivelet me të gjithë pronaret e rinje e të vjetër për të vazhduar me shpejtesi ndryshimet. Në jemi të gatshëm dhe do të mbeshtesim kete proces duke kontribuar në vazhdimësi për një bashkëpunim me të mirë dhe për ndryshimet që duam të gjithë.

Në shpresojmë se politika ka aritur një maturi që të stimulojë me dëshirë organizimin dhe institucionalizimin e Shoqatave të Perdorueseve të Pyjeve dhe (Oponencen e sajë). Tanime dhe në kete sektor nuk mungon rivaliteti konstruktiv, niveli i debatit, institucionet reale dhe ka permiresime në treguesit e transparencës dhe të demokracisë.

Demokracia edhe institucionet e pavarura ndërtohen me një shoqëri që duhet institucionalizuar

Mendojmë se na duhen ligje që perqendrohen në ceshtjet kryesore të Fondit Pyjor, funksionet kryesore, problemet e pronësise e të perdorimit, ndarje të menaxhimit dhe kontroll të ligjit, decentralizim të vertete dhe delegim të kompetencave me qëllim që të gjitha menaxhimet e detajuara të jenë të lena në strukturat/organizimet e deleguara.

Strukturat për pyjet e ndara sipas pronësise e perdorimit do të bëjnë me më pergjegjesi menaxhimin e pyjeve e kullotave.

Një strukturë në nivel qendror pa konflikt interesi duhet të jetë për tu përfshirë për zbatimin e ligjit duke kontrolluar të gjitha pronat që ka DSHP, KOMUNA dhe Privati.

Në jemi të sigurte që keto ndryshime do të ndikojnë shumë shpejt në permiresimin e menaxhimit të Pyjeve në Shqiperi.

## Pylli në rrugën nga komuna tek fshati e përdoruesi

Nga takimet e realizuara në Qarkun e Dibres nga komunat Ulez e deri në Reç, deshmojnë se pergjithësisht në kujtesën e banoreve është ruajtur mjaft mirë e drejta e familjeve në perdorimin e pyllit e Kullotes. Takimet e zhvilluara në dy nivele, në nivel Komune dhe në nivel Fshati, kanë evidentuar shumë dukuri të cilat duhet të jenë në vëmendjen jo vetëm të aktoreve që merren me pyjet, por dhe



Pylli i meshteknave. Kala e Dodës

■ Në kushtet e krijuara jemi para një situatë kur Ministria duhet të vazhdojë të konsultohet në të gjitha nivelet me të gjithë pronarët e rinje e të vjetër për të vazhduar me shpejtesi ndryshimet.

të vendim-marrjes, për të kuptuar se pronat jo vetëm kanë ZOT por dhe shumë banorë u kanë dale në perkrahje atyre për të mos i lenë ashtu si u shkretuan për vite me radhe. Mbi 70 % e banoreve rezultojnë me gure e kufij të qarte të njohur nga banoret dhe kjo ka bere që sejcili të perdore pyllin e kulloten që i kanë lenë trashëgim të parët dhe asnjë nuk arrin të shkojë e të perdore atë që e ka me kufij.

Për të parë sa i forte është ky rregull i vendosur historikisht ndër keto krahina në arriem që, gjatë vitit 2008, të marrim pjesë në disa keshilla komunash kur ato po kerkonin të pronat të transferohen në pronësi të Komunave në Tomin, Kastriot, Zërqaq, Ulez, Xiber, etj. Banoret jo vetëm janë të qarte çfare kerkojnë, por dhe po arrijnë të bëjnë perpjekje maksimale për të ndaluar dhe shfrytëzimin e pyjeve të lartë që po demtohen me dhe pa leje për shfrytëzim. Në Xiber nuk janë sqaruar banoret nese duhet dhe pse duhet shfrytëzuar pylli dhe ato janë mjaft të pakenaqr kur sipas tyre shfrytëzimi behet dhe në pyje me vlere mbrojtese nga erozioni në kuoren e fshatrave të rrezikuar prandaj ata kanë vendosur të mos lejojnë prerjen e pyjeve që i konsiderojnë të tyre. Keshilltaret, që janë dhe pronarë pyjesh të vogla, në Tomin vetëm mbas tre here debatesh arrihen të hartojnë dhe miratojnë kerkesën që pronat (përfshirë dhe pyjet dhe kullotat) të kalonin në pronësi të Komunes dhe në hapin tjetër të kalojnë në pronësi të privatit me vendim nga keshilli i Komunes sipas vendimit dhe tradites që ekziston ndër shekuj në keto treva.

## Pergjegjeshmeria e Komunes dhe Komuniteteve për menaxhimin e Pyjeve

Të marrësh pronat dhe veçanerisht pasurine me të cmuar për vendin që janë pyjet dhe kullotat do të thote që të marrësh pergjegjesi mbi vete angazhim dhe perkushtim për të mos i lenë në gjendjen që janë. Janë për të pergezuar privatet (perdoruesit dhe pronarët) tradicional të pyjeve në të gjitha rrethet e Veriut që kanë dhene modelet si duhet të ruhen e perdoren Pyjet dhe kullotat. Shembulli i Kalase Dodes dhe Kalisit janë shembulli se si duhen Komunitetet dhe komunitetet e perbashketa të ruajnë pronat e tyre dhe të perdorin me kujdes për të sotmen dhe të ardhmen. Natyrisht për të mesuar nga keta shembuj është mire të shohesh dhe të prekesh sepse me gazeta pak njerez i mesojnë ose s'duan të besojnë. Duhen parë nga afer si fshataret marrin vendime si kanë bere dhe respektuar "Itifaqet", sa roje kanë vendosur si i menaxhojnë pyjet dhe kullotat si vendosin për prerjen dhe kulloten, si perdorin të ardhurat dhe shpenzimet, si funksionon komisioni i fshatit dhe si i merrren vendimet.

Keto dite patëm rastin të takojmë K/fshatrave të Komunes Zërqaq dhe drejtuesit kryesor të cilet kishin marre vendimin e K/Ministrave për transferimin në pronësi të tyre të mbi 5000 ha Pyje e kullota. Kryetari i Komunes që është dhe specialist Pyjesh shprehet optimist për të ndryshuar gjendjen. Une cdo dite; thote ai, kam filluar të ndjeke nga afer demet që behen në zonat e largeta dhe do të ndaloj cdo lloj kondrabande dhe në Pyjet e Lartë dhe gjithashtu do të kerkoj nga Shteti që të transferohen dhe sipërfaqe të tje ra sepse mendoj se në kemi mundësi të mbrojmë e perdorim me mire dhe të perfitojmë me shume për të rritur të ardhurat e banoreve. Për kete, krahas rojeve që ndjekin punën në mbeshtetje të tyre cdo dite është dhe policia e shtetit që ndihmon në punën për parandalimin e demeve.

Ndersa Kryetari i Keshillit të Ko-

munes u shpreh; Une kam lexuar me kujdes ligjin dhe vendimet e Qeverise dhe me rezultojnë se ligji nuk pershtatet në të drejtat e pronareve që po marrin pyjet që janë Komunitetet dhe Komunitetet e tyre. Në nuk kemi të drejta sipas ligjit sepse në ligj njihet pronar është Ministria e Mjedisit dhe kjo duhet ndryshuar menjehere por dhe duhen deleguar dhe me shume buxhete nga Shteti tek Komuna për menaxhimin dhe perdorimin e Pyjeve. Sipas nesh por bazuar dhe në vendimin e Qeverise në po mbeshtesim dhe forcojmë shoqatën e perdorueseve të Pyjeve e Kullotave Komunal duke bere zgjedhje të reja. Shoqata do të jetë për në një hallke e rendesishme jo vetëm për pyjet e perdorueseve që banoret i kanë marre sipas tradites por të kujdeset dhe menaxhojë e mbrojë dhe pyjet kolektive në baze fshati e Komune që ka me shume veshtersi dhe gjendja e tyre është mjaft e degraduar.

Shoqata ka në perberje të saj krahas bordit dhe një Pylltar që është teknik pyjesh me shume pervojë dhe që punon me një program të caktuar dhe mbi bazen e planit të menaxhimit për pyjet dhe kullotat që janë transferuar nga Shteti tek Komuna dhe nga Komuna tek Komunitetet.

Pal Qoku kryetari i Komunes Ulez (inxhinjer Pyjesh) është mjaft optimist për vendimin që ka marre Qeveria për transferimin e rreth 5000 ha pyjeve nga shteti në pronësi të Komunes. Une- tha Pali kam vendosur deri tani në punë një inxhinjer Pyjesh që do të merret me punën konkrete në menaxhimin e pyjeve se bashku me perdoruesit dhe shoqatën e ngritur në nivel komune. Në teritorin tone është ndaluar cdo demtim dhe kondranda që ishte në pyjet e lartë. Mendoj se mundet të kerkoj keshillit të Komunes të punesoj dhe disa specialist që aktualisht paguhen nga DSH P në teritorin e Komunes por gjithmone duke i vlerësuar në aspektin e efektivitetit në punë për të mundësuar parandalimin e cdo demtimi të paligjshëm. Mendoj se shume shpejt shteti do të transferoj krahas pyjeve dhe buxhete për të mundësuar me shume sherbime për pyjet dhe vecanerisht

# mjedisore

**Ne Diber ka mbi 2000 ha Plantacione lajthi e eger dhe kur shikon planet masat e planifikuara shkojne deri te mbrojtja per prodhim fruti. A eshte kjo e mjaftueshme per nje plan 10 vjecare? A nuk ka masa te tjera c'duhet bere me lajthin, kur kemi 16000 ha toke te boshatisur ne Qarkun e Dibres. Kete gje mundet te themi dhe per geshtenjen e cila ne te gjithë rajonet ka nevojë per luftim kanceri shkalbezime dhe rrallime kur eshte e perzier me dushk ne moshë te ndryshme ose dhe sherbime te tjera per te rritur prodhimin.**

mbrojtjen dhe parandalimin e zjarreve.

Jane keto shembuj qe mendoj se duhet te njihen dhe perkrahen nga te gjitha keshillat dhe drejtuesit ne Njesite e QVendore per te hedhur hapa te guzimeshme dhe per te garantuar nje menxhim me te mire te pyjeve dhe te ardhura me te medha per nje jete me te mire per banoret.

Bazuar ne vendimin e Kministrave nr 396 dt. 21. 6. 2006 Pas marrjes ne dorezim te pyjeve bazuar me te dhenat e kadastrës dhe hartes qe do te merren nga Shteti (DSHP) ne Komuna realizohet menjehere identifikimi i perdoruesve te pyjeve komunale ne nivel perdoruesi, grup perdoruesish apo fshati dhe behet pajisja e tyre me kartela perdorimi atje ku projekti i pare nuk i ka realizuar.

## Planet e menaxhimit dhe certifikimi i perdorueseve

Keto detyra natyrisht kane nje baze ligjore qe eshte vendimi nr. 396 i Keshillit te Ministrave, si dhe termat e referencës ku perdoruesit pajisen me kartela perdorimi, veprim qe duhet te behet ne cdo plan menaxhimi duke percaktuar disa elemente baze te cilet jane:

Kerkesat e perdorueseve, kufijte midis perdorueseve, kushtet e perdorimit si dhe forma e menaxhimit.

Bazuar dhe nga pervoja e deritanishme ne mendojme qe hartuesit e planeve te menaxhimit duhet te shtojne ose dhe te respektojne me shume kujdes disa elemente qe lidhen me kartelat e perdorueseve si numrin e druveve per fazat e zhvillimit dhe keshilla praktike per pyjet e fermereve me shume funksione e moshë. Konsulentet qe bejne planet perdorin akoma metodat klasike te specialistit te pyjeve ne veprimet dhe rekomandimet per pyllin dhe territorin.

Ne takimin e realizuar ne Arras per rritje kapacitetesh me shoqaten, fermeret perseriten kerkesen e tyre qe projekti te mbeshtese me punime permiresuese per sherbelen. Faqja e Cidhnes nje siperfaqe me mbi 300 ha prodhonte para disa vitesh mbi 2000 kv sherbele me nje cmim tregu rreth 150-200 lek dhe me nje treg te garantuar pra me nje leverdi te madhe per te siguruar te ardhura per fermeret. Por a eshte ne fokusin e punes grupit te punes cfare duhet te behet ne kete plantacion per te (cliruar) nga bimët e tjera si shkozen e Lajthin qe ka arritur te hijezoje dhe bllokoje zhvillimin normal te sherbeles. A jane bere planifikime per mbjellje te sherbeles ose krijimin e kushteve

brenda rajonit. Fakte te tilla qe kerkojne me shume vemendjen e konsulentit jane jo vetem per sherbelen por dhe per bimët e tjera.

Ne Diber ka mbi 2000 ha Plantacione lajthi e eger dhe kur shikon planet masat e planifikuara shkojne deri te mbrojtja per prodhim fruti. A eshte kjo e mjaftueshme per nje plan 10 vjecare? A nuk ka masa te tjera c'duhet bere me lajthin (rrallime, ricungime apo veprime te tjera studime per mbjellje te reja kur kemi 16000 ha toke te boshatisur ne Qarkun e Dibres) kete gje mundet te themi dhe per geshtenjen e cila ne te gjithë rajonet ka nevojë per luftim kanceri shkalbezime dhe rrallime kur eshte e perzier me dushk ne moshë te ndryshme ose dhe sherbime te tjera per te rritur prodhimin. I permendem keto shembuj per te sjelle ne vemendjen e konsulenteve qe hartojne plane se formulat klasike te nje specialisti pyjesh duhen harmonizuar me kerkesat e fshatareve kur kemi te bejme me plane qe jane me vlere per njerezit per sherbime e prodhime qe gjenerojne te ardhura dhe jo vetem te ardhura nga produktet drusore por dhe te tjera qe njerezit kane nevojë cdo dite dhe prandaj jetojne ne keto male.

Per cdo perdorues kur merr pyjet ne Perdorim sipas planit duhet te jene ne certifikaten ose nje leter ne doren e perdoruesit dhe kjo leter te jete nje plan per fermerin dhe nje pergjegjesi per perdorimin dhe menaxhimin e pyllit qe ka marre ne perdorim sherbimet qe ai do ti beje pyllit dhe te ardhurat qe krijon nga perdorimi.

Bazuar nga diskutimet dhe debatet e zhvilluara per planet e menaxhimit me keqardhje konstatojme se shpesh komunat tenderojne njerez te papergjegjeshem dhe "Firma" qe jo vetem nuk kane konsulencen e nevojshme per te hartuar nje plan menaxhimi, por ne shume raste perben konflikt me hartuesin e planet dhe monitoruesin qe eshte DSHP.

Kur debatohen hapat dhe termat e referencës per hartimin e planit te menaxhimit fillojne pretendimet dhe justifikimet e shumta se mungojne buxhetet e nevojshme per te hartuar planet, per te ndare pyjet sipas perdorueseve, per tu konsultuar me perdoruesit per menyren e perdorimit te pyjeve, per pajisjen e perdorueseve me kartela perdorimi. A vlejne keto justifikime kur ke termat e referencës dhe objektivat e projektit, kerkesat e shtetit per reforme dhe vendimin Qeverise nr 396 dt 21. 06. 2006 por dhe per faktin se si hartues plani i ke pranuar dhe ke firmos nje kontrate?



U SHËNUA 51 VJETORI I "PËRPPJEKJES": NJË MISION HISTORIK

# Breza studentësh me penë dhe me këngë

Në organizim të një grupi entuziastësh, mbrëmjen e 27 qershorit 2008 në hotelin "Viktory" të Prishtinës, ish anëtarët e Shoqatës Letrare Muzikore "Përpjekja", përkatësisht studentë që asokohe studjonin në Universitetin e Beogradit, shënuan 51 vjetorin e themelimit dhe të veprimtarisë së kësaj shoqate. Në vitin 1957 studentët shqiptarë, Ramiz Kelmendi, Besim Bokshi, Agim Gjakova, Zekerija Cana, Fahredin Gunga, Ali Aliu, Rexhep Hoxha, Din Mehmeti etj, që studjonin në Universitetin e Beogradit, themeluan Shoqatën Letrare "Përpjekja", që u bë vatër e rëndësishme ku tuboheshin studentët shqiptarë nga Kosova, Maqedonia dhe Mali i Zi.

Me qenë se në Akademinë e Muzikës në Beograd studjonin edhe shumë studentë shqiptarë, kjo shoqatë disa vitë më vonë u shndërua në Shoqatë letrare-muzikore "Përpjekja". Kjo shoqatë nëpërmjet krijimeve letrare dhe këngës së bukur muzikore ishte rymë e fuqishme e shprehjes së identitetit kombëtar shqiptar, ishte guxim dhe entuziazmi i djelmohave syptremur që me aktivitetet e tyre nëpërmjet organizimit të mbrëmjeve letrare dhe të koncerteve muzikore, nxitin kulturën shqiptare.

Në vitin 1967 kjo shoqatë kremtoi solemnisht 10-vjetorin e themelimit dhe ishte promotore që në bashkëpunim me shoqatat e tjera simotra universitare, e organizoi me plot sukses kremtimin e 500 Vjetorit të vdekjes së Gjergj Kastriot Skenderbeut, në të gjitha qendrat ku studjonin studentët shqiptarë në Beograd, Zagreb, Lublanë, Sarajevë, Prishtinë, Shkup, dhe Dibër e Strugë, me një program të pasur recitalo- letrar dhe muzikor. Në këtë manifestim u inkuadrua edhe Shoqata kulturore-artistike studentore "Ramiz Sadiku" nga Prishtina me dramën "Trimi i mirë me shokë shumë".

Në këtë mbrëmje jubilarë të datës 27 qershor 2008, në sallën e madhe të restorantit "Viktory" në Prishtinë, në mënyrë solemne u shënuua 51 vjetori i Shoqatës letrare-muzikore "Përpjekja".

Faik Hima, ish aktivist i "Përpjekjes" dhe prezenues në koncertet e kësaj shoqate, duke e hapur këtë manifestim, theksoi: "Mirëse keni ardhur në shënimin e 51 vjetorit të themelimit të Shoqatës letrare-muzikore "Përpjekja" të studentëve shqiptarë nga të gjitha trojet shqiptare të ish Jugosllavisë që studjuan në Universitetin e Beogradit. Kam nderin dhe kënaqësinë e posaçme që në emër të të gjitha gjeneratave tu përshëndes të gjithë të pranishëmve sonte këtu, të gjithë ata që punojnë jashtë Kosovës dhe të gjithë ata që për shkaqe të ndryshme nuk kanë patur mundësi që të jenë sonte me ne. Të përkujtojmë me nder dhe respekt të gjithë ata që nuk gjenden më në mesin tonë".

Rexhep Torte, kryetari i Shoqatës letrare-muzikore "Përpjekja" në vitin 1967, duke përshëndetur të pranishmit, u shpreh se: "Përpjekja ka bërë një mision historik. Ajo ka bërë historinë e vet nëpërmjet guximit të fjalës së shkruar dhe të këngës së kënduar. Në ato periudha të vështira pa asfarë droje, me guximin e vet

ruajti dinjitetin e kombit shqiptar. Duke rrezikuar jetën dhe të ardhmen e tyre ato djelmohë dhanë kontributin e vet në maksimum nëpërmjet fjalës së shkruar dhe këngës së kënduar. Unë me që pata nderin dhe fatin të jem kryetar i "Përpjekjes" në vitin 1967 mund të them se të gjitha gjeneratat bënë që "Përpjekja" të ishte sinonim i një rezistence kombëtare, i një vëllazërimi të qyteteve tona, sepse "Përpjekja" me programet e saj kulturore kudo që shkoi, krijoi miqësi dhe njohësi të cilat mbetën të paharura dhe që vazhdojnë edhe sot e kësaj dite. Në vitin 1967 "Përpjekja" shënoi dhjetë vjetorin e themelimit dhe me aktivitetet e saja mori pjesë edhe në shënimin e 500 vjetorit të vdekjes së Skenderbeut. Me shoqatat simotra në Zagreb, Lubjanë, Sarajevë, në Shkup Dibër e Strugë, i treguam asaj epoke se entuziazmi ynë ishte i pashuar. Në vazhdimësi të këtyre aktiviteteve lamë gjurmë të pashlyera me mbrëmjet letrare, me koncertet dhe nxitën shoqatat muzikore në trojet tona, mes tyre edhe shoqatën "Hajdar Dushi" nga Gjakova dhe "Liman Kaba" nga Dibra e Madhe për vizita të ndërsjella, për miqësi të çelnicit që vazhdojnë edhe sot e kësaj dite. Mirë u takovshim në përvjetorë të tjerë duke ju dëshiruar suksese e shëndet të gjithë neve që ende jemi gjallë dhe lavdi ju pastë shpirti atyre që nuk gjenden më mes nesh".

Behlul Beqa, ish aktivist i "Përpjekjes", tha se: "Në maj të vitit 1982 u përgatitëm ta shënojmë 25 vjetorin e "Përpjekjes", ishim të gatshëm që ta rumbullakësojmë një aktivitet të rëndësishëm me një akademi solemne, kishim ftuar mysafirët, mirëpo dy ditë para se të fillojë solemniteti, morrëm një letër nga Konferenca studentore e Beogradit se ndalohej të mbahej akademia qëndrore e "Përpjekjes". Ne nuk mujtëm me e kry një aktivitet, siç e patën kryer gjeneratat para nesh. Mendoj se duhet të organizohemi bashkarisht që vitin e ardhshëm ta përkujtojmë atë ditë që na u ndalua ky aktivitet i ynë".

Jahja Jaha, ish aktivist i "Përpjekjes" dhe njëri nga organizatorët e këtij solemniteti, u shpreh se: "Ne si grup organizues me këtë aktivitet e hapëm derën për aktivitetet e ardhshme që na presin, duke u përgatirur edhe më mirë për sublimimin e tërë aktiviteteve të "Përpjekjes".

Akademik Esat Stavileci, deklaroi se: "U luta ta mar fjalën si student i Universitetit të Zagrebit. Unë po i përcjell ndjenjat e ish studentëve të Universitetit të Zagrebit, sepse asokohe studentët shqiptarë të Zagrebit dhe ato të Beogradit mbanin lidhje të fuqishme. Në emër të atyre ndjenjave dhe të atij vëllazërimi të asaj kohe shprehim dëshirën që takohemi sa është e mundshme më shpesh për të evokuar kujtimet dhe aktivitetet tona".

Ky solemnitet me këngë e valle zgjati deri në orët e mëngjezit me këngëtarët Gjergj Kaçinari, Agim Rizvanolli, Osman Hoxha, Fehmi Xharra, Indira Kordiq, Beqir Zhuri dhe Vllaznim Mamushi.

Kujtojmë **Dalip Çilën, Hiqmet Ndreun e Qemal Bajramin**

që ndërruan jetë këtë vit, por që gjithë jetën e tyre ia kushtuan Dibrës dhe Atdheut

## In memoriam

Nga ditari i gazetarit / Ndërroi jetë patrioti **Qemal Bajrami**

# Tërë jetën për kombin dhe fshatin Sencë

Nga: **REXHEP TORTE**

Më 2 qershor 2008 në fshatin Sencë të Dibrës së Madhe në moshën 75 vjeçare papritur ndërroi jetë Qemal Bajrami, i përndjekuri, i burgosuri, i torturuar dhe atdhetari i patrembur për çështjen shqiptare. Ai u varros në fshatin e tij në praninë e familjes, farefisit dhe miqve të tij të shumtë.

### Mbresa nga takimi i fundit

Në fundvlerën e vitit 2007 së bashku me bashkëqytetarin tim Nexhmi Mati, i cili jeton dhe punon në Trento të Italisë, i shquar edhe si aktivist me mërgimtarët dibranë, vendosëm ta vizitojmë fshatin Sencë ku jeton dhe sfidon atdhetari Qemal Bajrami me bashkëshorten Asibe. Aty e gjetëm edhe Agimin djalin e tij me fëmijët që kishin ardhur nga Italia për ti kaluar pushimet verore në vendlindje.

Ky fshat ndodhet në lartësi mbidetare mbi 1000 metra, me qindra hektarë tokë, livadhe, me shumë burime uji të ftohtë dhe me shumë shpella që kanë shërbyer si strehimore edhe për cubat në lashtësi, por edhe për kryengritësit Elez Isufi e Bajram Curri me luftëtarët e tyre. Në kilometrin e 25 të rrugës Dibër-Shkup, në të djathtë degëzohet rruga tre kilometërse që ngjitet përpjetëzës, e ngushtë, e parregulluar dhe me plot kthesa e përrenj të kulluar, që çon për në fshatin Sencë. Ky fshat malor kufizë bjeshkëve të Bistrës përbën kufirin mes Rekës së Epërme dhe Rekës së Poshtme. Në lulëzimin e vet ka patur 50 shtëpi. Banorët janë shqiptarë muslimanë dhe ortodoksë, që dëshmohet edhe përmes varezave. Banorët e këtushëm flasin gjuhë të pastër shqipe. Ky fshat i bukur edhe pse me mundësi të shumta zhvillimi, për shkak të rrugës së keqe dhe qëndrimit e përndjekjeve moniste është braktisur thajse nga të gjithë. Qemal Bajrami i lindur në vitin 1933, i përndjekur, i burgosur dhe i torturuar, sëbashku me bashkëshorten Asibe nuk i kishte humbur energjitë e tij për të qëndruar dhe për t'i dalë zot këtij fshati malor.

### Dashamir i librit dhe diturisë

Qemal Bajrami, shkrimleximin e kishte mësuar në vitin 1941 nga Idriz Dega- mësues nga Peshkopia, pasi këtthehej në mbrëmje me bagëtinë. Edhe pse asnjë ditë nuk kishte shkuar në shkollë, në mënyrë autodidakte duke lexuar në vazhdimësi libra të ndryshëm, kishte arritur nivelin intelektual që kur bisedohe me këtë burë tejet komunikativ magjepseshe nga intelijenca dhe intelektualiteti i tij. Ky burrë modest dhe zemërgjerë e njihnte mirë historinë shqiptare, letërsinë e gjuhën shqipe dhe kishte një kulturë të gjerë e të larmishme.

Trashëgimia familjare e burrërisë dhe fisnikërisë dhe ngritja e tij, kishin bërë qysh në moshën e re të ketë horizonte të reagojë dhe kërkohë të



Qemal Bajrami me bashkëshorten, Asiben

drejtat e shqiptarëve dhe hapjen e shkollës shqipe në këtë fshat.

### Përpjekje për ta vrarë konsullin turk

Qëndrimi i tij i palëkundur për çështjen kombëtare shqiptare ia vuri pas UDB-enë. Kjo përndjekje e policisë u intensifikua sidomos në vitin 1953, pas kryerjes së shërbimit ushtarak në Shabac afër Beogradit.

Siç rrëfente Qemali, "Gjersa këthehesha nga shërbimi ushtarak në stacionin e trenit në Shkup më prekën thellë në shpirt skenat e përlojta të ndarjes së shqiptarëve që mërgonin për në Turqi. Këto skena më irituan dhe e mbushëm plot mllef shpirtin tim atdhetdashës ndaj padrejtësive të shtetit. Asokohe u përpoqa që t'i bëjë edhe një atentat konsullit turk në Shkup, për të shprehur revoltën time kundër shpërnguljes së shqiptarëve në Turqi, por nuk mu krijua asnjë mundësi e volitshme për ta kryer këtë aksion. Megjithatë nuk ndejta duarkryq, gjeta një libër me adresa dhe fillova të shkruaj letra adresuar institucioneve në Shqipëri, Gjermani, KQ të LKJ-së, Rankoviqit, Titos e funksionarëve të tjerë në Ish Jugosllavi, ku shprehja revoltën e time për popullin shqiptar që është vënë në rrezik, që është lënë pa shkollë shqipe dhe që është i detyruar të mërgojë për në Turqi. Nga letrat e shumta që dërgova mora përgjigje vetëm nga Kabineti i Titos, me të cilën më njoftonin se, " letra ime është dërguar për shqyrtim në Kuvendin e Maqedonisë".

### Pas grilave tortura deri në alivanosje

"Kur Titua vizitoi Mavrovën në vitet 50-ta, tregonte Qemal Bajrami,

policia u përpoq të më burgosën, por duke qenë gjithnjë vigjilent shpëtova pa u kapur. Policia më arrestoi më vonë në befasi ndërsa isha duke lëvruar tokën".

Më dërguan në burgun e Gostivarit me padinë se gjoja isha spiun i Shqipërisë, duke më nxjerrë dëshmitarë të rrejshëm. Gjatë kohës së hetuesisë ndaj meje u përdorën torturat më mizore, duke më ratur, duke më lënë të ngjitur për muri më shumë se dy ditë, duke më futur në ushqime supatanca të ndryshme që herë më bënin agresiv, herë bija në depresion dhe herë më rinin sytë hapur, me dhembje koke e me pagjumësi. Nga këto tortura sytë mu bëjnë si zgavra dhe këmbët mu ajën. Të gjitha këto bëheshin me asistimin dhe direktivat e udhëheqësve Stojçe nga Vrutoku dhe Arizan nga Belçica.

Në vitin 1957 në Gjiqin e Qarkut në Tetovë më dënuan tre vjet burg. Në vitet 1958\59 në Idrizovë u takova edhe me patriotin Rifat Palloshi. Mjeku çifut psikiatër ushtarak nga Zagrebi kur më pa se kisha mbetur kockë e lëkurë, njëherë më më sugjeroi të shtiresha si memec dhe kështu më lëshuan në shtëpi. Nga dyshimi se mos më zbulojnë për këtë diagnozë të rrejshme, shtatë muaj nuk fola as me anëtarët e familjes sime, duke menduar se ndoshta nga gëzimi dikuj do t'i shpëtonte goja dhe do të merrej vesh kjo punë. U martova në vitin 1959. Gjatë kësaj kohe UDB-ja ushtronte agresivitet të madh ndaj shqiptarëve të këtyre anëve. Vërbjani u dogj tri herë, 1951/52 dhe 1953, Sencën e dogjën në vitin 1961 me pretekst se goja zjarri është shkatuar nga mjetet shpërthyes. Në vitin 1966 bëra agjitacion që Arizani i kompromituar të mos zgjidhej deputet. Më kujtohet një e djelë kur forcat policore i ishin

### Bashkëpunimi me vëllezërit Gërvalla

Në vitin 1967, rëfente Qemali, "duke parë se ndiqesha vazhdimisht nga UDB-ja, u detyrova të mërgoj në Austri. Kur mora lajmin se edhe atje UDB-ja më ndiqte për të më vrarë, kalova ilegalisht në Gjermani. Në Gjermani fillova të kontaktoj ambasadën e Shqipërisë dhe të merrem me propagandimin dhe distribuimin e shtypit shqiptar dhe të filmave shqiptarë. Kjo më dha mundësi që të njihem me Jusuf dhe Bardhosh Gërvallën që ishin si melhem për çështjen shqiptare, me Kadri Zekën, Enver Hadrin, Halil Alidemajn, Hysen Gegajn, Rexhë dhe Mustaf Iberdemaj, Maksut dhe Ruzhdi Saramati, Ibrahim e Muhamed Kelmendi dhe shumë intelektualë tjerë të devotshëm shqiptarë.

Në vitin 1981 me ardhjen e demokracisë, pas shumë vitesh në mërgim u ktheva në vendlindje në Maqedoni për të parë gruan dhe fëmijët e mij. Gruaja ime Asibe ka vuajtur shumë. Ajo në mungesën time me peripeci të papara i riti fëmijët Vahidenë që tashmë është martuar dhe jeton në Kërçovë, Dilaverin dhe Agimin që tash jetojnë e punojnë në Trento të Italisë dhe Albanën që është martuar dhe punon e jeton në Ninberg të Gjermanisë".

afruar shtëpisë sime për të më arrestuar. Këtë e vërejtë vajza ime e vogël Albana, e cila më sinjalizoi dhe unë i shoqëruar nga dhëndri im Ferhat Sula, brenda natës kalova nga fshati Sencë, nëpër Dibër në Kërçovë".

### Preokupim kishte gjallërimin e fshatit

Gjatë vizitës sonë disaorëshe, Qemali shprehte shqetësimet e tij për mërgimin e rinisë shqiptare, rrezikun e asimilimit në vendet e huaja, nevojën që mërgimtarët të investojnë në vendlindje si shprehje të atdhetarizmit, përçarjet dhe antagonizmat e panevojshme të partive shqiptare.

Jeta në fshat është kënaqësi. E kam organizuar që të fumizohem edhe me shtypin ditor në gjuhën shqipe, ndërsa lajmet në radio dhe televizionin i ndjek rregullisht. Pranvera dhe vera këtu janë shumë mahnitëse. Këtu

merrem me shartimin dhe kultivimin e pemëve frutore dhe me rritjen e bagëtisë, ndërsa dimri ndodh të jetë i ashpër, por sasia e mjaftueshme e drurit na e bën ta kalojmë më lehtë.

Unë nuk mund ta parafytyroj jetën pa Sencën. Anipse jetoj vetëm me bashkëshorten. Tani ka filluar të gjallërojë fshati dhe disa po ndërtojnë shtëpi të reja. Këtu janë të gjitha kushtet për zhvillim të mirfillt të bujqësisë, blektorisë, peshkimit dhe turizmit. Ka burime të shumta uji dhe tokë të punueshme. Pengesë kryesore është asfaltimi i 3 kilometrave të rrugës. Për rrugën e fshatit derisot nuk ka menduar asnjë pushtetar dhe asnjë parti politike. Ka shumë gurbetçinj të interesuar për tu këthyer në vendlindje", na tha Qemal Bajrami në bisedën e fundit që patëm, i rrethuar nga djali Agimi me fëmijët që kishin ardhur për t'i kaluar pushimet verore në Sencë.

### NEKROLOGJI

**Dalip Çila, një patriot dhe antikomunist i dëshmuar**

**Jamaica Ave. Woodhaven Quens(NY)**: Një nga veteranët e komunitetit Dalip Çila, patriot dhe antikomunist i dëshmuar, vdiq në moshën 87 vjeç, pas një sëmundjeje të gjatë. Ai bënte pjesë në grupin e Rezistenca antikomuniste të Dibranëve, në atdhe dhe mërgim. Dalipi ishte nga fshati Topojan i Grykës së Vogël në rrethin e Dibrës. Lindi në vitin 1921 dhe vdiq më 7 korrik. 2008. Në momentet e fundit të jetës ju gjendën afër vajza e tij Suzana dhe dy djemtë e tij Kurt e Zgfrid.

Nw vitin 1958 Dalipi martohet me një vajzë gjermane Anën, me të cilën martohet më vitin 1958 dhe do t'a humb atë një sëmundje e rëndë dhe e pa shërueshme më 1980. Me Anën ai pati edhe dy fëmijë Kurtin dhe Suzanën që i qëndruan afër së bashku me fëmijën që Ana solli me vete Zgfridin, i cili i qëndroi pranë si fëmija e tij deri ditën e fundit të jetës së tij.



"Të gjithë ju që keni ardhë nga të gjitha anët me i dhënë lamtumirën e fundit një vëllaut tonë të dashtun që u nda nga kjo botë në mbrëmjen e 7 korrikut 2008. Me vdekjen e tij thuhet se përendojë edhe një yll i ndritur i "qiellit shqiptar" nga komuniteti ynë. Pasë kryerjes së të gjitha shërbesave fetare sipas rritit mysliman në xhaminë e Bruklinit, nga Imam Gëzim Hysenagolli, në varrezat publike "Maple Grove Cementry" në Keë Graden(Queens) u bë varrimi i tij.

BEQIR SINA

Folklori është një trashëgimi universale vlerash kulturore, artistike, historike, filozofike etj., por mbi të gjitha është trashëgimia më e kapshme e unitetit shpirtëror kombëtar.

Nga: PËRPARIM TOMÇINI

## Dibra, kryeqendër e folklorit shqiptar

Dibra si trevë etnofolklorike kufi zohet me treva të tilla si Kukësi, Prizreni, Tetova, Gostivari, Kërçova, Struga, Librazhdi, Mati dhe Mirdita. Si e tillë kjo trevë merr pothuajse përmasat e një kryeqendre të folklorit shqiptar pasi përveç influencave që kjo trevë ka tek të tjerët që e rrethojnë dhe anasjelltas gjejmë edhe element folklorik të trevave të tjera më të largëta si në jug ashtu edhe në veri të Shqipërisë.

Të tillë elementë janë instrumentet muzikore si gurët apo lahuta që i gjejmë edhe në skajet më veriore të trojeve shqiptare, gajdeja që gjendet në Klenjë të Dibrës sikurse e njëjtë që gjendet edhe në Pogradec, Korçë apo Ohër, fustanella, kostumeve ceremoniale të burrave e shumë e shumë elementë të tjerë, dhe ajo që është më e rëndësishmja, kemi një mori këngësh të njëjta me ato që këndohen në trevat e tjera shqiptare po sigurisht në stilin, dialektin, motivin muzikor dhe shoqërikimin instrumental të trevës përkatëse. Shembuj të tillë janë këngët e cikit të kreshnikëve, motra me katër vëllezër, kënga e Imer Agës, kënga e Kalasë së Shkodrës, këna e Sulçe Begut etj; si dhe këngë që këndohen akapela (pa shoqërim) ato që në interpretimin e tyre në grup këndohen me dy zëra dhe në momente të veçanta me tre zëra sipas melodisë dhe virtuositetit të këngëtarëve duke na sjellë të gjallë në këta faza elementin folklorik shumë shqiptar që është polifonia. Të tilla këngë këndohen në fshatrat në kufi me Kërçovën, me Gostivarin e Tetovën ku në këto zona njihen me termin popullor këngët e Pollogut.

Shembull tjetër por jo me element polifonik kemi këngën "A gjegjesh, a nuk gjegjesh" e cila në përmbajtja është identike me këngën "Tanë moj e zeza Tanë" ose siç njihet ndryshe



"Fyelli i Tanës" e cila këndohet në jug të Shqipërisë e kryesisht në Përmet, apo kënga "Përmbi varr të djalit të ri" që është e ngjashme me këngën "Mbeç more shokë mbeç" që këndohet në Skrapar dhe në vise të tjera të jugut;

Te varianti i Dibrës ndër të tjera thuhet:

*Kur t'ju pyes nana për mue  
I thoni nanës, asht martua  
Në pyet nana, ç'nuse muer  
Veç dy plumba në krahanuer  
Një përballë, tjetri tërthuer... etj.*

Kurse në këngën "Mbeç more shokë mbeç" thuhet:

*Në pietë nënaje për mua  
I thoni që u martua  
Në pietë se ç'nuse mori  
Dy plumba nga kraharori  
Në pietë se ç'krushqë i vanë  
Korvat venë e hanë.*

Interesante është kënga e Imer Agës, personazhin kryesor të të cilës

Imer Agën profesor Eqerem Çabej e quan analog me Uliksin tek "Iliada dhe Odisea" të Homerit. Ku megjithëse në periudha të ndryshme historike edhe Uliksi ishte dhjetë vjet në luftë, edhe Imer Aga nëntë vjet e nëntë ditë, Uliksi ishte rob i Çirçës, Imer Aga rob i vajzës së mbretit të Spanjës, Uliksit deshën t'i marrin Penelopën parësia e Itakës, Imer Agës, agallarët e vendit, Uliksin e njëh e shoqja nga një nishan që kishte në këmbë, Imer Agën e njëh e shoqja nga një nishan që kishte në krah.

*- Ti moj nuse moj e shkretë  
Imer Agën a po e njëh  
- M'ka pas thanë e zeza nanë  
N'krah të djathtë ka një nishan  
E ka ngranë gjoku me dhamë  
Imer Aga përvesh krahin  
Nusja e re e hoq dullakin  
- Udhë e mbarë o ju krushq bujarë  
Unë po marr burrin e parë.*

Një këngë tjetër me përmasa harmonike është edhe "Martesa e Halilit" tek cikli i kreshnikëve ku thuhet aksioni i rrëmbimit të Tanushes së bukur (motra e krajlit), ashtu sikurse Paridi rrëmben Helenën.

Tek libri i Ismail Kadaresë "Autobiografia e popullit tim në vargje" autori kur na shpjegon për rrugën e tërthortë të shprehjes së një mendimi të caktuar dhe pikërisht kur bëhet fjalë për bukurinë e Helenës thotë se Homeri përballë bukurisë së saj vuri pleqtë e zymtë të Trojës të cilët kur kalonte Helena bëheshin shumë të gjallë e dinamikë. Kështu dilte në pah madhështia e bukurisë së Helenës e cila nuk mund të thuhet me fjalë të rëndomta.

E njëjta gjë ndodh edhe me Tanushen e bukur. Populli këtu mbledh të gjithë bukurinë e natyrës dhe i kometon në një trup të vetëm që ishte Tanusha.

*Shtegu i ballit si shtegu i malit,  
ku len hana me prenue*

*Dhambët e saj si gurët e zallit,  
fill mas shiut kur bien dielli*

*Qerpiku i synit si krah i dallëndishes... etj.*

Pra Tanusha u bë njësh me bukurinë e natyrës dhe arriti puna deri aty sa u bë edhe sinonim i së bukurës. Sot në Dibër (në Muhurr dhe në Kala të Dodës) ka fise me mbiemër Tanushi ose Tanusha të cilët e trashëgojnë këtë mbiemër nga një farë bukurie relativisht e qëndrueshme e fisit të tyre në shekuj. Po ashtu emri Tanush edhe Tanushe është përdorur edhe si emër i veçantë njerëzish, por ka edhe fshatra me emrin Tanushe, i tillë është fshati Tanushe në kufi me Dibrën dhe Gostivarin, i cili e meriton të ketë emër sepse në të vërtetë është një vend me bukuri natyrore të mrekullueshme ashtu sikurse ka Tanushe edhe në Tetovë i cili ka të njëjtat karakteristika si Tanusha e Dibrës që fatkeqësisht ka ngelur jashtë kufirit shtetëror.

Pra konkluzioni është ky. Natyra dhe njeriu janë një, natyra bën të bukur njeriun, njeriu bëri të bukur natyrën. Natyra i dha gjithë çka kishte të bukur Tanushes dhe Tanusha idhuroi natyrës emrin e saj.

Për kaç sa thamë në këto pak shënime për folklorin e Dibrës, me shembujt që përmendëm arrijmë në përfundimin se folklori shqiptar në tërësinë e tij në kushtet historike që ka kaluar Shqipëria është një trashëgimi universale vlerash kulturore, artistike, historike filozofike etj., por mbi të gjitha është trashëgimia më e kapshme e unitetit shpirtëror kombëtar.

Edhe folklori i Dibrës është pjesë e tërësisë së kësaj trashëgimie me veçoritë dhe specifikat e saja të veçanta për të cilat mund të flasim në shënime të tjera.

### NEKROLOGJI

## U shua Hiqmet Ndreu, një zë i fortë shqiptar antikomunist në Australi

Hiqmet Ndreu, vdiq javën e kaluar në një nga spitalet publike të Melbourne - Australi më 14 korrik 2008. La pas vetes vëllanë Pellumbin e Kapllanin, motrën Kujtimen (motra tjetër Arife e martuar tek Valerët, ka vdekur para pesë vjetëve). Gjithashtu ka lënë edhe një vajzë me emrin Selvie, në Australi, e cila e kujdes deri në ditën e vdekjes. Dhe u përkushtua deri në dërgimin e trupit të tij në vendin e të parëve - varrezat e fisit Ndreu ngritur në fshatin Sllovë - Peshkopi. Vendi, ku trupi i tij tani trete i qetë siapas edhe amanetit që kishte lënë ai vetë të tretej me eshtrat e Elez Isufit - Ndreu, Suf Xhelilit - Ndreu e Cen Elezitet - Ndreu, të cilët lanë emër të madh në historinë e Shqipërisë, shpreht i hidhruar nipi i tij Çezar Ndreu.



Hiqmet Ndreu, lindi në fshatin Sllovë - Peshkopi, në vitin 1928. I biri i Islam dhe Hyrie Ndreut, ose i pari i pesë fëmijëve të kesaj familje pinjollësh. I biri i denjë e njerës prej familjeve më të mëdha shqiptare, e fisit Ndreu, më zë, dhe e i njohur si - Familja e Deres se Madhe së Ndreut të Sllovës (Dibër) ose e familjes e cila njihet nga këto anë si një prej atyre fisve të cilat bënin pjesë në "Kuvendin e Burrave", të

thirrur "Shtatë Malet e Dibrës". Ndërsa vet babai i tij Islami, është djali i madh i Cen Elez - Ndreu.

Hiqmeti, si fëmija i parë e kësaj dëre (Islam Ndreut), kur i ati i tij ishte në detyrë në atë kohë, dhe ishte i punësuar, si zyrtar i qeverisë së at'hershme në zonën e Zerqanit të rrethit të Dibrës, do të merete edhe edukimin e tij të parë, në shkollat e kësaj zone, e cila njihet për një nivel të lartë arsimorë në këto anë.

Sikurse, edhe vetë i ati i Hyqmetit - Islam Ndreu, një intelektual dhe patriot i madh, pasi kreu shkollën filllore, dhe 8- vjeçare, u regjistrua dhe përfundojë edhe shkollën e Fulcit në Golem - Kavajë. Pasi përfundojë shkollën, ai shkoi me shërbim si prefekt i Ulqinit. Kohë, kjo ku vetë Hiqmeti at'here i vogël kreu shkollën 8-vjeçare atje, pra në Ulqin. Bëhet fjalë për periudhën 1928 -1936.

Në vitin 1942 Hiqmeti regjistrohet në shkollën e "Mesme të Tiranës", deria sa e përfundojë atë dhe në vend të "deftesës", studenti i shkëlqyer dhe me një talent të rallë, mori në dorë urdhëresën e qeverisë së Hoxhës, për t'u internuar në kampet e punës së detyrueshme. E filloi në rrethin e Beratit -

Kuçovë, së bashku me qindra familje të tjera patriotë, nga të gjitha anët e Shqipërisë.

Në korrik të atij viti si shumë i ri që ishte, e liruan dhe ai kthehet në Sllovë në të njëjtën kohë që pjesa më e madhe e familjes së tij qëndronte ende në llogoret e intermimit, e burgjet e presekutimit komunist, në Tepelenë, Porto Palermo, Fabrika e Tullave, kampi i Mal-iqit, kampi i Radostinës, kapi i Kriporës së Vlorës e tjerë. Me të mbushur moshën e dërgojnë të shërbejë në një repart pune në ushtrinë shqiptare. Lirohet nga ushtria pasi kreu atë me pune dhe kujdes për të mos rënë viktimit dhe internohet përsëri. Por, kësaj rradhe në një kamp tjerë të punës së detyrueshme - në kampin e e fshatit Lllakatundë - zonat e thella të lumit të Vlorës.

Në vitin 1952 së bashku me dy kushërinjët e tij Faik e Nazmi Ndreu, arriti në saj të aftësive të tija të arratiset. Si fillim doli në ish-Jugosllavi ku menjëher u arrestua dhe u dërguan në burgun e Gerovës në Kroaci. Deri sa më 1956 emigroi nga Ish Jugosllavia për në perendim, në Itali.

Për këtë në librin e tij publicistik me titull "Një thirrje Mëmedhut" në parathënjën e tij shkruhet, se "Çfarë ka ndërë vallë djaloshi 18 vjeçar, nipi i Elez Isufit, tek kapërcente kufirin shqiptar në vjeshtën e largët të vitit 1952? Brengë të pashoqe, acar që thua do t'i

nginte shpirtin dhe gjithsesi keqardhje. Keqardhje për legjendën e nëpërkembur të fisit, për kullat e djegura të Sllovës nga serbi, gjermani italian, për diktaturën hoxhiste që do të ndiqte hap pas hapi edhe jetët e sapoçeluar të shqiptarëve pas luftës vëllavrarëse ideologjike.

I frymëzuar gjithë jetën e tij nga patriotët e mëdhenjë fillojë të merrej në kampet e emigrantëve në Itali me veprimtari atdhetare e patriotike, duke u lidhur me patriotët e tjerë në atë kohë, të cilët qëndronin në këto kampe pasi ishin arratisur me ardhjen e mortajës komuniste në Shqipëri. Në vitin 1957 nga Italia, për arsye vetjake zgjodhi Australinë e largët, për të emigruar. Ku edhe atje si veprimtar dhe njeri shumë aktivë sidomos për çështjen kombëtare, u lidhë me grupet shqiptare patriotike e anti -komuniste atje. Për Hiqmetin veprimtaria dhe aktiviteti tij kishte vetëm një Shqipëri dhe një çështje shqiptare, si në Shqipëri, Kosovë e Çamëri dhe viset e tjera të okupuara nga serbët. Ai u dallua në Australi, komunitetin shqiptarë, si një ndër udhëheqësit e demonstratave, për lirinë e të drejtat e shqiptarëve, të mohuara dhë shkëlura brabarisht në Maqedoni, Mal të Zi, Preshevë, Bujanovc, Medvegje e Çamëri. Për 23 vjet punojë në radion A3 të Melbourne, dhe u morë me shkrime publicistike.

B.SINA, H.RAMA

Doruntina Disha, shpreson se së shpejti ndoshta do të ketë ftesa edhe nga shtëpitë e produksioneve shqiptare, kombit, të cilit ajo edhe i takon...

# DORUNTINA DISHA, dibrania që befasoi norvegjezët!

## Ylli i ardhshëm

Para tri vjet, Doruntina Disha fitoi vendin e Parë, në një konkurs të këngës moderne (pop/rock muzikë) në Oslo, ku doli edhe singëli i parë i saj me titullin: "Dream World". Ajo tashme ka publikuar edhe këngën e dytë "I Burn 4 you", te cilën e nxori në CD në tri versione.

"Kur unë konkurova në audicion-idol të këngës në Norvegji (Iloj i Etheve të së Premtes në Shqipëri), mora përgjigjen nga juria, se jam ende e re. Si duket për mua paska qenë më mirë që nuk shkova më tutje, sepse ashtu do të mbetesha vetëm si një pjesëmarrëse në idol dhe, nuk do isha ajo që jam", - thotë Doruntina. Ajo ndjek studimet në Oslo, është studente shembullore, është e lindur në Prishtinë në Kosovë, dhe thotë se ajo është e lindur për me kënduar.

"Kam filluar të vallëzoj gadi si dyvjecare, më pastaj kam lozur në flautë dhe kam kënduar në kor plot shtatë vite. Unë kam shumë dëshirë të këndoje si dhe të jem në skenë. Kjo jam unë dhe kjo është e vërteta ime!"

## Melos bregdetar

Doruntina pati shansin, si shumica e të rinjëve që, gazeta norvegjeze "Dag

bladet" të zhvillojë intervistë për rubrikën e vet "Çka po ndodh", që ka për qëllim prezentimin e ëndrave të të rinjëve. Doruntina ka trokitur tash më në botën e yjeve. Ajo do të bëhet yll! "Singëli "Dream World" më arriti nëpër radiostacionet më të njohura të

Norvegjisë. Producentët parashikojnë se do të jet një hit veror. Ajo është një këngë që edhe vallëzohet, mundemi ta quajmë "Dance-trance", një këngë që është shumë e përshtatme për vendet bregdetare. Dhe "Dream World" pason shumë mirë me ëndrat e jetës, ndaj unë ndjehem sikur jetoj në një botë të ëndra ve për momentin. Cdo gjë ndodhi shumë shpejt", kujton Doruntina..

## Idoli më ndihmoi

Para tri vitesh, Doruntina Disha u paraqit në një audicion të këngës së mbajtur në qendrën Linderud në Oslo. Në këtë audicion e kishte paraqitur një shoqe e saj, pa ditur fare për këtë Doruntina. "Poëer Hit Radio" aranzhoi "Power Star Search" (kërkimi i yllit power), sipas një koncepti amerikan. Doruntina u paraqit me këngën e Celine Dions "My Heart eill go on", këngë nga filmi "Titanic" e që e interpretoi për mrekulli. Kjo i mundësoi të kalojë në finale.

"Më pastaj këndova këngën "I love rock`n`roll" të Brytney Spears dhe e mposhta skenën me një paraqitje spektakulare" - thotë Doruntina. Diçka e papritur dhe e pabesueshme. Më kryesorja ndodhi në qytetin Drammen, 40 km larg Oslos. Ishte finalja e garës së yjeve të

**D**DORUNTINA DISHA lindi më 4 korrik 1988 në Prishtinë. Në moshën 4 vjeçare së bashku me familjen e saj migroi këtu në Norvegji, ku edhe sot jeton në Oslo dhe studion psikologjinë. Fillimisht, vlen të theksohet se në Festivalin e 46-të të Këngës në Shqipëri, Doruntina Disha në një duet me Flaka Krelanin renditen në vendin e dytë, me këngën "Jeta kërkon dashuri".

Në fillim të kësaj bisede, vlen të përmendim se Doruntina, poashtu ka qenë e dalluar në mesin e publikut shqiptar në Norvegji, ku si e vogël që nga moshën 4 vjeçare kur ka ardhur në shtetin tonë, ajo, me recitime, këngë e vallëzim karakteristike i ka kënaqur bashkëkombësit e saj nëpër festa, veçarisht gjatë kremtes së 28 Nëntorit-Ditës së Flamurit e të Pavarësisë së Shqipërisë.

Ajo është bija e intelektualit-Osman Disha nga Dibra dhe e nënës Fakete Disha, ekonomiste nga Gjakova e Kosovës. Babai i saj gazetar e komentator sportiv shumëvjeçar i Televizionit të Kosovës, tash korrespondent i RTK, nga Oslo.



Parapërgatitje para daljes në skenë-D.Disha

adhëshëm. Shkëlqeu në mesin e 10 konkuresëve finalist dhe bëri për vete mbi 5000 shikues, edhe pse ajo ishte vetëm një vogëlushe e panjohur për ata dhe i entuziazmoi me

interpretimin brilant të një pike muzikore nga këngëtarja e mirënjohur botërore-Shakira me lëvizjet e përsosura skenike. Kështu që juria profesionale e Poëer Hit Radios, nuk



Doruntina duke kënduar në garat pop/rok muzikë

e pati aspak të vështirë të shpallë fituesen: Doruntina Disha.

Kompania Norvegjeze "Dream Factorys" iu deshën vetëm pesë ditë që të nxjerrë singëlin e saj të parë në treg. "Nga një herë nuk arrij dot të kuptoj se unë kam fituar. Megjithatë unë ndjehem shumë e përgatitur dhe krenare, sepse, mbështetje të veçantë morale kam nga ana e prindëve të mi të dashur dhe nga vëllau im i shtrenjtë-Driloni, të cilët vazhdimisht më japin vullnet duke më ndihmuar qindpërqind që të arrij një sukses kaq të madh" - shton Doruntina.

Gjatë pushimeve verore, Doruntina thotë se ajo dhe familja e saj do

të vizitojnë Shqipërinë, Kosovën e Maqedoninë, ku i ka të afërmit e familjes së saj, nga se janë duke u aranzhuar një mori koncertesh nëpër Norvegji, nga ana e Kompanisë menaxhuese së saj.

Doruntina Disha, poashtu shpreson se së shpejti ndoshta do të ketë ftesa edhe nga shtëpitë e produksioneve shqiptare, kombit, të cilit ajo edhe i takon. Njëherë rit ajo i përshëndet të gjithë shqiptarë kudo që janë anë e mbarë Botës.

(Marrë me shkurtime nga gazeta norvegjeze "Dagbladet". Përshtati në shqip për gazetën "Rruga e Arbërit", **IBRAHIM EGRIU**)

## PAJTOHUNI NË GAZETËN "RRUGA E ARBËRIT"

Pajtimet në Tiranë mund t'i bëni pranë redaksisë së gazetës në numrat: Cel: 068 31 19 232 ose në numrin fiks 22 33 283.

Pajtimet në Peshkopi mund t'i bëni pranë librarisë "Fleta XXI", pranë Gjinnazit "Said Najdeni", me nr. tel: 0218 4233.

Të interesuarit për abonime duhet të lënë patjetër emrin e saktë dhe adresën ku presin t'ju shkojë gazeta.

**- KËRKOHEN KORRESPONDENTË NE RRETHET DIBËR, LEZHË, DURRËS.**

**- BENI NJOFTIMIN TUAJ TE BIZNESIT**

**Bëhuni pjesë e gazetës!**

Numri i radhës së gazetës do të dalë çdo të diel të fundit të muajit.

Tel. (04) 22 33 283. E-mail: rrugaearberit@gmail.com.

www.dibra.org



botime & studio grafike

libra-revista  
gazeta - fletëpalosje  
postera-broshura  
kartolina-ftesa  
kartvizita  
shërbim fotografik

mirë.... bukur.... lirë....

00355 4 22 33 283  
069 20 68 603  
mbotime@gmail.com